# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com








Viti XXVI - Nr. 7849 E premte 12 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


Opinioni i Ditës

Nga PËLLUMB KARAMETA

## Të ndihmojmë mësuesit të përsosin kompetencën e komunikimit



Pak ditë më parë, Profesori i nderuar Rami Memushaj, në shkrimin "A duhet futur mësimi i gjuhës amtare në universitete", ndër të tjera, konstatoi: "Nuk ...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga JORGJI KOTE

## Të ndajmë "shapin nga sheqeri" diplomatik



Kjo thënie m'u kujtua këto ditë kur si ish-koleg komunikova me tre diplomatë të Misionit tonë pranë BE-së në Bruksel, të cilët figurojnë në listën e mediatizuar ...

Vijon në faqen 21



Ping-pong fajtorësh, eurot "në arrati"

# Ushtria në Rinas, Meta: A ka bazë ligjore? Xhaçka: S'jemi në luftë

Rama: Forcat ushtarake edhe në aeroportin e Parisit. Basha: Grabitja, lidhje qeveritare

Nga VALENTINA MADANI

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, i kërkoi dje zyrtarisht informacion shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollça-kut, mbi bazën ligjore të vendosjes së efektivëve të Policisë Ushtarake dhe Batalionit Special të ...

Në faqen 3

EMRAT/ TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, KUSH MERR PARATE PER TRUALLIN

# KOMPENSIMI I PRONAVE, 620 FAMILJET QE MARRIN PARATE

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë. Dokumentet që nevojiten, karta e identitetit dhe llogaria bankare aktive



*(Në foto)* Ndërtime informale

Në faqet 10--11

VENDIMI

## Pensionet, hyn në fuqi shtesa, llogaritjet për 660 mijë përfitues

Në faqen 12

ASAMBLEJA

## Largimi i Antoneta Sevdarit, përplasje mes Arta Markut dhe prokurorëve

Në faqen 8

TENSION NE MBLEDHJE

## Ankesat, Komisioni i Prokurimeve anulon një tjetër tender tek "Unaza"

Në faqen 9

REAGOJNE PRINDERIT



## Vrasja e Marvi Mihalit, gjykata dënon me 55 vite burg 4 të rinjtë

Në faqen 7

Zbardhet lista me emrat e "spiunëve" të diktaturës në institucionet shtetërore

# Raporti, 30 zyrtarë bashkëpunëtorë të Sigurimit

*Autoriteti për Informimin mbi Dosjet dorëzon të dhënat në Kuvend*

Më shumë se 30 zyrtarë kanë rezultuar të kenë qenë agjentë ose bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit. Të dhënat janë zyrtare të Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të përfshira në raportin vjetor për 2018-ën, që ky institucion




ka dorëzuar në Kuvend. Siç raportohet në këtë raport, gjatë dy viteve të para të funksionimit të këtij institucioni janë hasur rreth 30 zyrtarë apo kandidatë të tjerë që kanë rezultuar se në të shkuarën kanë qenë pjesë e strukturës famëkeqe ...

Në faqen 6

MONUMENTET

## Qeveria miraton Këshillin e Trashëgimisë, kush i ndalon ndërtimet

Në faqet 18-19

## ANGAZHIMI I USHTRISE

### DEBATET

Ministrja: Kompania s'ka investuar për sigurinë, preferon të paguajë gjoba

# Balluku: Koncesionari i TIA-s po luan me kontratën

## Grabitja e 10 milionë eurove, masat që do të ndërmerren në Rinas



Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku paralajmëron ndërhyrje të forta në aeroportin e Rinasit, pas ngjarjes së ndodhur dy ditë më parë, ku u grabitën rreth 10 milionë euro të katër bankave të nivelit të dytë, të cilat do të transportoheshin jashtë vendit. Në konferencën për mediat, Balluku tha se tashmë nuk ka asnjë mundësi diskutimi me administratorët lokalë të aeroportit dhe se bisedimet për hapat e mëtejshëm do të zhvillohen me drejtuesit e kompanisë koncesionare në qendër. Balluku tha se do të ketë një serë ndërhyrjesh për garantimin e sigurisë së aeroportit dhe gjithashtu edhe në drejtim të cilësisë. Ndërsa në lidhje me një hap të mundshëm për prishjen e kontratës koncesionacore, Balluku deklaroi se për këtë hap ka një serë pengesash, për faktin se në këtë rast kemi të bëjmë jo vetëm me kontratën, por edhe me rregulla ndërkombëtare. "Nuk e prisnim këtë përsëritje të situatës dhe masat që janë marrë nga konceisonari ishin të pamjaftueshme. Kuptohet që ajo që është kërkuar është investim i madh dhe nuk është kërkesë rregullatorë, por në kushtet e shkeljes dhe precedentëve që kemi, duhet të ishin bërë. Koncesionari nuk është i interesuar për të investuar për sigurinë e aeroportit, duke cenuar sigurinë kombëtare. Kam kërkuar që në Tiranë të vijnë përfaqësuesit më të lartë të 'Everbright', që do i takoj sot pasdite. Do iu kërkoj një ndërhyrje në kohë rekord, por kjo është një bisedë që do e bëj pasi të zhvilloj këtë takim", - tha Balluku. Ndërsa në lidhje me lidhje me rolin e TIA-s, ministrja u shpreh si ky institucion ka treguar mungesë profesionalizmi. "Menaxhmenti i TIA-s ka treguar mungesë profesionalizmi. Ka qenë një komunikatë e pamenduar dhe e parakorduar mes Tiranës dhe Hong Kongut. Kjo është një çështje që duhet hetuar nga prokuroria, përgjegjësit nuk do i nxjerrë as Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, as ndonjë ministri tjetër. Koha ka mbaruar për të toleruar konceisonarin kinez për të vazhduar e ndërtuar parkingje dhe të mos plotësojë parametrat e sigurisë. Cilësia në aeroportin e Rinasit do të ndryshojë, sepse ka ardhur koha që të investohet edhe në shërbim, sepse konceisonari po luan me këtë kontratë dhe nuk po e merr seriozisht", tha Balluku.

## "Rinasi", Vasili: Xhaçka e Lleshaj, njëri i bie gozhdës, tjetri patkoit

Ish-deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili, reagoi dje pas deklaratës së ministres Xhaçka dhe ministrit Lleshaj, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në aeroportin e Rinasit. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Vasili shkruan se janë thjesht bashibozukë dhe njëri i bie gozhdës e tjetri patkoit. "Xhaçka thotë s'është cenuar siguria kombëtare në Rinas, Lleshaj thotë po, mos janë kapur gjë nga ndonjë koncesionar i ri? Xhaçka alias ministrja e Mbrojtjes thotë me gojën plot se nuk është cenuar siguria kombëtare në Rinas. Ky Lleshaj alias ministri i Brendshëm thotë në Kuvendin e Shqipërisë, edhe ky me gojën plot, që është cenuar siguria kombëtare. Këta janë thjesht bashibozukë dhe njeri i bie gozhdës, tjetri patkoit. Është provë e qartë që kjo qeveri është e kapur dhe e mbaruar krejt. 'Ishalla' nuk është kapur qeveria nga ndonjë koncesionar i ri… I gatshëm të rrëmbejë thelën e radhës Aeroportin ndërkombëtar të Rinasit".







Policia Ushtarake, dje në aeroportin "Nënë Tereza"

### Integrimi dhe çelja e negociatave me BE-në, s'varen më nga Shqipëria

## Grabitja, Balla: Deri javën e ardhshme do të kemi rezultate nga policia





Nga foltorja e Kuvendit, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, shprehu mirënjohje për reagimin e duhur dhe në kohë nga ana e Policisë së Shtetit lidhur me rastin e grabitjes në Rinas. "Në emër të maxhorancës, dua ta falënderoj dhe ta përgëzoj Policinë e Shtetit për reagimin për herë të parë pas kaq shumë vitesh të ngjarjeve të ngjashme jo vetëm në kohë, por të vënë në një sulm me armë të rënda, granata apo armë automatike. Policia e Shtetit ka arritur të asgjësojë një prej kriminelëve, të ketë plagosur njërin syresh dhe të jeni të bindur që deri në javën e ardhshme rezultatet e Policisë së Shtetit do të jenë të tilla, që të paktën të merrni mundimin sikurse nuk e morën kurrë mundimin kolegët tuaj pararendës në karriget që mbani, të falënderoni për herë të parë punën e Policisë së Shtetit", - deklaroi Balla. Ndërkohë që duke folur për procesin e integrimit dhe çeljen e negociatave me BE-në, ai tha se tashmë kjo gjë nuk varet më nga Shqipëria, por nga gjendja e vetë vendeve anëtare.

### CEREMONIA





## Babai i Stresit ngushëllon familjen e grabitësit të vrarë në Rinas

**TIRANË** - Nesër në Tropojë do të zhvillohet ceremonia e varrimit të Admir Murataj, njërit prej grabitësve të 10 milionë eurove në aeroportin e Rinasit. Lajmin për ceremoninë mortore e ka dhënë vetë vëllai i tij, Ilir Murataj, poshtë postimit të së cilit nuk kanë munguar as komentet e ngushëllimeve.Mes personave që i kanë shprehur ngushëllimet Ilir Muratajt, është dhe Sali Lushaj, babai i Stresit. "Ngushëllimet e mia për familjen tuaj të nderuar. Zoti ju forcoftë", shkruan Lushaj. Nuk dihet se çfarë e lidh Muratajn me Sali Lushajn, por ajo që dihet është se ata janë nga e njëjta zonë.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:**0688087823*-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**




FA në perimetrin e aeroportit, presidenti i kërkon shpjegim shefit të Shtabit

# Ushtria në Rinas, Meta: S'ka bazë ligjore. Xhaçka: S'të marrim leje

## Ministrja e Mbrojtjes: Nuk ka debat kushtetues

**OLTA XHAÇKA**
"Prioriteti ynë kryesor është siguria e qytetarëve, sigurimi i infrastrukturës kritike të NATO-s dhe FA, siç është edhe aeroporti dhe patjetër imazhi i vendit, që në këtë moment nuk duhet të cenohet. Nuk ka pse të njoftohej presidenti. Nuk po shkojmë në luftë, nuk ka cenim të sigurisë kombëtare", deklaroi zj.Xhaçka.

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, i kërkoi dje zyrtarisht informacion shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçakut, mbi bazën ligjore të vendosjes së efektivëve të Policisë Ushtarake dhe Batalionit Special të Forcave tona të Armatosura në perimetrin e sigurisë së aeroportit "Nënë Tereza. Duke iu përgjigjur interesit të gazetarëve për këtë çështje, zëdhënësi i kreut të shtetit, Tedi Blushi shprehet se presidenti i ka kërkuar Shtabit të Përgjithshëm të FA informacion mbi bazën ligjore të vendosjes së ushtrisë në këtë territor. "Presidenti i Republikës i ka kërkuar zyrtarisht informacion shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçakut, mbi bazën ligjore të vendosjes së efektivëve të Policisë Ushtarake dhe Batalionit Special të Forcave tona të Armatosura në perimetrin e sigurisë së aeroportit 'Nënë Tereza'", tha Blushi në një përgjigje të mediave. Dy ditë më parë ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, njoftoi se ushtria do të merrte nën kontroll sigurinë e perimetrit të jashtëm të Aeroportit të Rinasit. Ky vendim erdhi pas grabitjes së ndodhur pasditen e së martës në pistën e avionëve.

**REAGIMI**

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka iu kundërpërgjigj dje Presidentit Meta për angazhimin e ushtrisë në aeroportin e Rinasit se nuk kishte pse të njoftohej presidenti për vendosjen e ushtrisë aeroportin e Rinasit. Reagimi i saj erdhi pasi presidenti i kërkoi Shtabit të Përgjithshëm të FA informacion mbi bazën ligjore të vendosjes së ushtrisë në këtë territor. "Prioriteti ynë kryesor është siguria e qytetarëve, sigurimi i infrastrukturës kritike të NATO-s dhe FA, siç është edhe aeroporti dhe patjetër imazhi i vendit, që në këtë moment nuk duhet të cenohet. Nuk ka pse të njoftohej presidenti. Nuk po shkojmë në luftë, nuk ka cenim të sigurisë kombëtare", deklaroi zj.Xhaçka. Ajo bëri të qartë se gjysma e pistës është infrastrukturë ushtarake dhe policia ushtarake do të qëndrojë aty deri në momentin e vendosjes së sigurisë në aeroport. "Nuk është debat kushtetues, nuk ka dislokim trupash, nuk kemi luftë, nuk kemi situatë të cenimit të sigurisë kombëtare, ku do të duhet të kishim marrë një miratim të parlamentit, jo të presidentit. Nuk jemi në kohë lufte dhe nuk kemi në fakt as emergjencë. Kemi vetëm cenim të sigurisë së një objekti të rëndësisë së veçantë, të rëndësisë së parë, po ashtu në mënyrë të pazgjidhshme dhe integrale, infrastrukturë ushtarake po ashtu. Pothuajse gjysma e pistës është infrastrukturë ushtarake, i takon Komandës së Forcës Ajrore dhe gjysma tjetër është për përdorim civil. Aeroporti 'Nënë Tereza' është pikë kritike po ashtu, sepse këtu ulen edhe avionë ushtarakë. Njëkohësisht kemi prezencë ushtarake edhe në Autoritetin e Aviacionit Civil. Kjo është infrastrukturë ushtarake pjesërisht dhe cenimi i së gjithës patjetër na cenon edhe ne. Nuk ka debat kushtetues, nuk po shkojmë në luftë apo dislokim trupash. Po diskutojmë marrje masash të sigurisë të një infrastrukture ushtarake. Deri në vendosjen e masave të sigurisë dhe moscenimit të aeroportit, ne do jemi këtu edhe pse kemi një detyrim ligjor", tha zj.Xhaçka.


Presidenti i Republikës, Ilir Meta


Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka

**ILIR META**
"Presidenti i Republikës i ka kërkuar zyrtarisht informacion shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade, Bardhyl Kollçakut, mbi bazën ligjore të vendosjes së efektivëve të Policisë Ushtarake dhe Batalionit Special të Forcave tona të Armatosura në perimetrin e sigurisë së aeroportit 'Nënë Tereza'".

### Dy rastet kur ndërhyjnë Forcat e Armatosura

## "Ushtria", Kushtetua: Në gjendje të jashtëzakonshme dhe fatkeqësi natyrore

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, dy ditë më parë urdhëroi vendosjen e efektivëve të Policisë Ushtarake dhe Batalionit Special të Forcave të Armatosura në perimetrin e Aeroportit Ndërkombëtar në Tiranë. Por, Kushtetua dhe ligji përcaktojnë qartë rolin dhe misionin e Forca të Armatosura në vendin tonë. Referuar ligjit themeltar të shtetit, ato mund të përdoren në dy raste: në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme dhe për parandalimin, ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore. Kushtetua e Republikës së Shqipërisë në nenin 173 të saj parashikon që: 'Në rast rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike, Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave mund të vendosë në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit gjendjen e jashtëzakonshme, e cila zgjat për aq kohë sa vazhdon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë. Me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme, ndërhyrja e forcave të armatosura bëhet me vendim të Kuvendit dhe vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje të rivendosin rendin. Zgjatja e afatit të gjendjes së jashtëzakonshme mund të bëhet vetëm me pëlqim të Kuvendit çdo 30 ditë, për një periudhë jo më shumë se 90 ditë"! Neni 22 i ligjit të pushteteve të drejtimit e Forcave të Armatosura sqaron më tej: "Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, kryeministri është drejtpërdrejt përgjegjës për drejtimin e Forcave të Armatosura, përmes hierarkisë së drejtimit e të komandimit, i cili pas përfundimit të kësaj gjendjeje të jashtëzakonshme i raporton Kuvendit për përdorimin e Forcave të Armatosura gjatë kësaj periudhe". Sa u përket faktkeqësive natyrore, ligji shprehet në nenin 23 të tij, ku thotë se për fatkeqësitë natyrore vendos Këshilli i Ministrave, sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. "Me vendosjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Forcat e Armatosura, me vendim të Këshillit të Ministrave mund të ndërhyjnë për eliminimin e pasojave të ardhura nga fatkeqësia natyrore apo aksidenti teknologjik".




## SHKURTE

### "Rinasi", Mediu: E papranueshme ndërhyrja e ushtrisë

Ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu, kundërshton vendimin e ministres së Mbrojtjes që ushtria të vendoset në territorin e aeroportit të Rinasit, pas ngjarjes së rëndë ku u grabitën miliona euro. Mediu teksa citon Kushtetutën thotë se është e papranueshme që FA-të të shndërrohen në instrumente të urdhrave politikë. "Ne jemi vend anëtar i NATO-s dhe është e papranueshme që FA-të të shndërrohen në instrumente të urdhrave politikë, nga kushdo që vjen në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën. Forcat e Armatosura kanë dy raste që mund të përdoren: a - Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, b - FA përdoren në rastin e emergjencave, si ndërhyrje e domosdoshme, pasi janë përdorur të gjitha mjetet dhe strukturat e tjera në dispozicion. Asnjë nga këto dy momente ligjore dhe kushtetuese nuk përputhet me atë çka ndodhi në Rinas, prandaj vendosja e strukturave ushtarake është jokushtetuese dhe joligjore dhe krijon një precedent të rrezikshëm për përdorim për interesa dhe qëllime jashtë misionit të tyre", shprehet z.Mediu.

### "Juntë ushtarake", Nishani: Meta duhet ta parandalojë

Ish-presidenti Bujar Nishani e quan dhunim të rëndë të rendit kushtetues, angazhim policor njësi të Forcave të Armatosura Ushtarake për ruajtjen e aeroportit pas grabitjes së miliona euro të 9 prillit. Nishani thotë se një vendim i tillë është prerogativë e sjelljes në modelin e një junte ushtarake dhe i kërkon presidentit Ilir Meta të ndërhyjë. "Presidenti i Republikës, si komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura duhet të ketë një vokacion të lartë në parandalimin e çdo akti që përfshin ushtrinë në veprime që dhunojnë rendin kushtetues. Forcat e Armatosura të një vendi anëtar i NATO-s nuk mund të sillen e veprojnë nën shembullin e regjimit bolivarian të Maduros", - shkruan Nishani në "Facebook".

Nga ana e Shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk eshte shpallur ankandi faza e pare per pasurite e meposhtme:
1-"Truall+Ndertese" me siperfaqe trualli 1328 m2 (nje mije e treqind e njezet e tete)dhe siperfaqe ndertese 508 m2 (peseqind e tete) me Nr.Pasurie 691/31 ne Zonen Kadastrale 1167, Volumi 8, Faqe 94 me adrese Komuna Berxhulle, Tirane.
Cmimi fillestar per shitjen ne ankand te pasurise eshte 881,600 (teteqind e tetedhjete e nje mije gjashteqind)Euro.
2-"Truall+Ndertese" me siperfaqe trualli 3761 m2 (tre mije e shtateqind e gjashtedhjete e nje) dhe siperfaqe ndertese 1818 m2 (nje mije e teteqind e tetembedhjete) me Nr.Pasurie 691/30 ne Zonen Kadastrale 1167, Volumi 8, Faqe 93 me adrese Komuna Berxhulle, Tirane .
Cmimi fillestar per shitjen ne ankand te pasurise eshte 1,280,000 (nje milion e dyqind e tetedhjete mije) Euro
Ankandi do te zhvillohet ne date 23.04.2019 ne oren 16:00 prane zyres se shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk me Permbarues Gjyqesor Privat Admir Beqiri te ndodhur ne adresen Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.1Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane

# GRABITJA NË RINAS
## PËRPLASJA

Kreu i PD-së, Ramës: Dështimin e policisë dhe qeverisë po ia faturon një kompanie private

# Grabitja në Rinas, Basha: Fakte tronditëse të lidhjeve qeveritare

## "Emërimi i Lleshajt, në shkelje të Kushtetutës"

Valentina Madani

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, akuzoi dje se në ngjarjen e grabitjes në Rinas ka lidhje të tmerrshme të qeverisë me krimin. Z.Basha u shpreh se Rama dhe qeveria e tij ka dështuar totalisht me koncesionet si në Rinas, edhe në mbarë Shqipërinë e se kompania kineze ishte dështim. Ai përmendi emra të lidhjeve qeveritare me krimin dhe tha se grabitja, sipas tij, është bërë me mbështetje qeveritare. "Kompania ka dështuar të sigurojë sigurinë, figuron të jetë në bashkëpronësi me Eno Bushin, avokat i George Rifomatos, piloti italian i rrëzuar me drogë. Bashkëshortja e tij, Joana Bushi është drejtoreshë e Trafikut Ajror dhe para kësaj ka qenë drejtoreshë e Belinda Ballukut. Për grabitjen ngrihen disa pyetje. Pse aksionerët e aeroportit nuk vepruan, të lidhur ngushtë me Ramën dhe Belinda Ballukun e me George Riforamton? Pse bandat grabitën prapë? Pse pas përplasjes me policinë, grabitësit u larguan? A janë 10 milionë eurot e vjedhura në dorën e bandës akoma? A janë të zbatuar dhe organet e rendit përgjegjës vetëm për paaftësi, apo kemi të bëjmë me bashkëpunim dhe grabitje të segmenteve të strukturave shtetërore? Këto lidhje janë njësoj si bashkëpunimi shtetëror në trafikun e drogës. Kemi pra struktura direkt bashkëpunuese në grabitje. Shteti i Ramës është i përlyer me vjedhjen, me krimin", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së vuri në dukje se kishte nxitim për të mbuluar aferën. "Nxjerrja e ushtrisë në aeroport u bë jashtë ligjit, tjetër krim kushtetues ky. Drejtësia e kapur nga Edi Rama nuk heton krimin e tmerrshëm. Kjo qeveri dhe ky kryeministër e grabisin çdo ditë këtë vend me forma të ndryshme. Ky është shkatërrim total i sigurisë totale. Autorët të dalin para drejtësisë. Çlirimi i vendit nga qeverisja e përlyer me krimin është emergjencë e çdo shqiptari patriot e të ndershëm", tha Basha. Për kreun e Partisë Demokratike, grabitja spektakolare në aeroportin e Rinasit të miliona eurove duke cenuar sigurinë kombëtare, mund të ishte parandaluar nëse socialistët do të njihnin ligj e Kushtetutë. "Do të ishte parandaluar, nëse do të zbatohej urdhri i ministrit të Brendshëm i datës 5 gusht 2018, nr. 130, i cili kërkon që Policia e Shtetit të shoqërojë dhe ruajë transportimin e vlerave monetare mbi shumën e 950 mijë lekë", theksoi z.Basha. Fakti i dytë për kryeopozitarin Basha është shkelja e Kushtetutës përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave të dhjetorit 2017. "Edi Rama ka shkelur Kushtetutën duke emëruar gjeneral Sandër Lleshajn në shkelje të nenit 167 të Kushtetutës, kryetar të Këshillit Drejtues të Aviacionit Civil, thënë ndryshe nën drejtimin e Këshillit të Aviacionit Civil nga Sandër Lleshaj, aeroporti nuk është vjedhur një herë, por dy", u shpreh kreu i PD-së. Fakti qëndron se ekziston një VKM e dytë, i muajit dhjetor 2018, që zëvendëson Sandër Lleshajn në krye të Këshillit të Aviacionit Civil me Artan Shkrelin, sot zv.ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë Elektrike.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha



Policia Ushtarake, dje në aeroportin "Nënë Tereza"

**AKUZA**

"Kompania private e sigurimit, që merr 5 euro nga çdo qytetar që kalon në Rinas dhe që nuk përmendet nga qeveritarët se ka dështuar në sigurim, figuron të jetë në bashkëpronësi të njërit nga personat më të afërt të PS, avokatit të PS-së, Eno Bushi, i njohur edhe si avokati i Giorgo Riformatos, pilotit italian që u rrëzua me avionin plot me drogë", - tha z.Basha.

## Grabitja në Rinas, Kryemadhi: Kriminelët nuk ndihen të rrezikuar

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, akuzoi dje pas ngjarjes në Rinas se qytetarë shqiptarë ndihen më të pasigurt. Kryemadhi tha se grabitja ne aeroportin e Rinasit është cenim jo vetëm i sigurisë kombëtare, por edhe i asaj rajonale. Kryemadhi akuzoi qeverinë për lidhjet me krimin, ndërsa tha se jeta e qytetareve është në rrezik nga bandat. Sipas Kryemadhit, qeveria nuk mban përgjegjësi, ndërsa institucionet fajin ia hedhin njëratjetrës. "Sot qytetarët shqiptarë ndihen të pasigurt, sepse aeroporti i Rinasit para-qitet si një objekt i atakueshëm nga kriminelët



sa herë iu duhet për ta atakuar këtë institucion, por edhe sa herë që iu duhen para për t'u bërë gati para zgjedhjeve. Qeveria në vend të marrë përgjegjësitë, u ikën atyre me një sjellje që i dekurajon qytetarët, duke u dhënë mbështetje kriminelëve, të cilët nuk ndihen të rrezikuar nga forca e ligjit, por ndihen të mbrojtur nga qeveria", tha Kryemadhi. Sipas saj: "Qytetarët e thjeshtë ndihen të pasigurt, sepse nuk është larguar asnjë nga detyra, ose të jetë thirrur ndonjë nga prokuroria. Ndërkohë arrestohen ata që luftojnë për të mbrojtur shtëpitë e tyre. Të gjithë ia hedhin fajin njëri-tjetrit duke bërë deklarata boshe. Sa herë që kriminelët hyjnë dhe duan të grabisin, është bërë i qartë dështimi i qeverisë, kësaj qeverie që nuk përfaqëson qytetarët, por përfaqëson bandat. Një polici e dorëzuar dhe e çorganizuar demonstron rënien e shtetit dhe që u shërben bandave".

## SHKURTE

### FA-të në Rinas, Strazimiri: Teknikisht është grusht shteti

Ish-deputeti i PD-së, Gent Strazimiri, në një postim në "Facebook" shkruan se teknikisht Shqipëria është në kushtet e grushtit të shtetit. Ai fton të gjithë mediat dhe gazetarët të pyesin ministren e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, mbi bazën e cilit nen urdhëroi vendosjen e Forcave të Armatosura në Rinas. "Në çdo rast është Kuvendi që merr vendimin për nevojën e përfshirjes së ushtrisë dhe përgjegjësinë në nivelin operacional e merr Presidenti i Republikës në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm, i cili e ushtron përmes shefit të Shtabit të Përgjithshëm (nëse Policia e Shtetit pranon që nuk e kryen dot detyrën për rivendosjen e rendit), ose komandantit të Forcave (në rast lufte)! Ministri në asnjë rast, 'asesi' nuk e ka këtë kompetencë në ligj. Teknikisht është grusht shteti, pavarësisht mosmarrjes seriozisht të mrrutave e rriqnave të ndyta që po e vënë në jetë...", deklaroi z.Strazimiri.

### "Hajdutët ikin", Tabaku: Skandal, në komisariat mbahen minorenë

Ish-deputetja demokrate, Jorida Tabaku, publikoi dje një foto për të cilën shprehet se në komisariat janë banorë të "Bulevardit të Ri", mes tyre edhe një minorene. Sipas saj, një vogëlushe 5-vjeçare ka përfunduar në qeli, ndërsa hajdutët u ikën poshtë hundëve. "Skandali i radhës. Minorenet brenda komisariatit 4 dhe mbi të gjitha një vogëlushe në moshën 5-vjeçare. Përfunduan në qelitë e ftohta, pasi i zgjuan me gaz lotsjellës përpara dy ditësh, i nxorën nga shtëpia sikur të ishin terroristë dhe i futën në qelitë e ftohta. Në kundërshtim me çdo akt, këto janë kriminelët që arrestojnë minorenë dhe u ikën hajduti poshtë hundëve në mes të aeroportit. Kjo është policia në shërbim të Ramës, që i nxin faqen Shqipërisë përditë"!


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pajisje dhe aksesorë për zonat e sigurisë për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,900,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pajisje dhe aksesorë për zonat e sigurisë për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 08 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Ministri: Turp, kemi transferuar sovranitet në duart e një koncesionari privat

# Rama: Forcat ushtarake, edhe në aeroportin e Parisit dhe Amsterdamit

## "Kush flet për juntë ushtarake, le të gjejë ndonjë arsye tjetër"

Mazhoranca qeverisëse është e bindur se ajo që nuk shkoi mirë në sigurinë e aeroportit "Nënë Tereza" në momentin e grabitjes së 10 milionë eurove ishte pikërisht mospërmbushja nga ana e kompanisë koncesionare të kushteve të saj të kontratës. Sipas qeverisë, papërgjegjshmëria e kompanisë solli cenimin e sigurisë kombëtare në vend dhe bëri të nevojshëm marrjen e sigurisë së aeroportit nga ana e ushtrisë dhe policisë. Kryeministri Edi Rama shmangu në fjalën e tij dje në Kuvend komentin për këtë çështje, por nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, ai e konsideroi të drejtë vendimin për të angazhuar ushtrinë në sigurimin e perimetrit të jashtëm të aeroportit. Sipas tij, jo vetëm kaq, por në shumë aeroporte të vendeve më të zhvilluara në botë ushtria kontrollon sigurinë dhe në ambientet e brendshme të aeroportit. Për këtë, ai publikoi edhe foto nga raste të ngjashme në botë. "Forcat ushtarake në aeroportet e Parisit, Venecias, Frankfurtit dhe Amsterdamit, janë vendosur ashtu si në plot vende të tjera të Europës dhe botës demokratike, si reagim ndaj akteve cenuese për sigurinë e infrastrukturave aeroportuale dhe qytetarëve që i përdorin ato. Ndërkohë që beretat e kuqe të policisë sonë ushtarake janë vendosur thjesht në ruajtje të perimetrit të jashtëm të sigurisë. Prandaj kush flet për shkelje Kushtetute, gjendje lufte, juntë ushtarake e marrëzira të tjera si këto, le të gjejë ndonjë arsye tjetër për të treguar se sa shumë i dhimbsen Kushtetuta dhe standardet demokratike", - shkroi Rama.



Kryeministri Edi Rama

**INTEGRIMI**

"Shqipëria i ka plotësuar detyrimet për të hapur negociatat me BE-në. Jemi në kushtet kur nga brenda vendit u jepet forcave që janë kundër zgjerimit e që s'e mirëpresin çeljen e negociatave, një ushqim kundër interesave të këtij vendi. Nuk duam ta asgjësojmë PD-n-ë por ta mundim", -tha Rama.

### LLESHAJ

Ndërkohë që nga foltorja e Kuvendit, ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, sqaroi se ajo që dështoi ishte kompania koncesionare dhe jo policia. Madje, sipas tij, policia arriti të që të reagojë në kohë, ndërsa pranoi që ngjarja e Rinasit ishte seria e pestë e një seriali të nisur prej kohësh. "Sigurisht, ajo nuk ishte ngjarja e parë, ishte seria e pestë e një seriali që ka nisur prej kohësh, në të cilën ka shumë aktorë dhe autorë. Ajo që ndodhi pardje, ajo e veçanta në raport me seritë e mëparshme të këtij seriali është që forcat e sigurisë kanë reaguar, kanë reaguar fort dhe kanë dhënë një goditje që nuk është dhënë prej shumë e shumë kohësh ndaj bandave kriminale, që kanë tentuar të cenojnë një aset të rëndësishëm të infrastrukturës kritike të vendit, po deshe edhe të sigurisë kombëtare", - u shpreh Lleshaj. Më tej, ministri i Brendshëm u shpreh se ngjarje të tilla ndodhin kudo, por ai theksoi se policia dhe institucionet shtetërore kanë marrë masa të menjëhershme për të zhbërë atë, që ai e konsideroi si histori të turpshme, marrëveshjen koncesionare të gati 20 viteve më parë. "Është një ngjarje e rëndë, një precedent i rëndë, i ndodhur kur ne kemi transferuar sovranitet në duart të një koncesionari privat, të cilin në qoftë se t'i hynit historisë së tij, mund të shihni të gjitha duart që kanë kontribuar në të dhe besoj që do të gjeni edhe shumë duar dhe emra të njohur që kanë kontribuar në këtë situatë", - u shpreh ministri. Sa i përket rolit të ushtrisë, Lleshaj theksoi se ai është tërësisht ligjor dhe në mbështetje të forcave të rendit. "Jo, të nderuar zotërinj, për ju edhe për të tjerë që janë të shqetësuar për këtë, po ju them qartësisht: Forcat e Armatosura të Shqipërisë e kanë në mision kushtetues sigurinë kombëtare të Shqipërisë. Nëse ne konstatojmë se kjo siguri është cenuar, apo edhe thjesht kërcënuar e pa u prekur, por thjesht ka një kërcënim, Forcat e Armatosura kanë detyrë kushtetuese të japin kontributin e tyre për këtë situatë. Sigurisht, ato nuk kanë hyrë atje si Forca të Armatosura, ato kanë hyrë në detyrë si mbështetje ndaj strukturave të Policisë së Shtetit", - tha Lleshaj.

## Gjoni i kërkon dorëheqjen, Lleshaj: Nuk kam asnjë brengë për postin

Deputeti opozitar, Ralf Gjoni, i kërkoi presidentit që të mbledhë Këshillin e Sigurisë Kombëtare, ndërsa i bëri thirrje ministrit Lleshaj që nëse për 2-3 javë nuk kapen autorët dhe të gjenden lekët të japë dorëheqjen, teksa javën e ardhshme njoftoi se do ta thërrasin në interpelancë. "Zoti Lleshaj, unë në vendin tuaj, nëse fajtorët e këtij krimi nuk identifikohen dhe konfiskohen paratë, do të kisha dhënë dorëheqjen, jo sot, por brenda 2-3 javëve. U kërkoj kolegëve të opozitës të kërkojmë interpelancë me ministrin e Brendshëm që të japë llogari për rendin publik. Presidenti të mbledhë Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Hyn tjetri me armë atje, mund të vriste, apo të merrte peng avionin", - tha Gjoni. Ndërkohë, në përgjigje të kësaj deklarate, Lleshaj tha se nuk kishte asnjë brengë për ta lënë postin e ministrit, por këtë gjë do e bëj kur ta gjykoi ai. "Dhe meqë më përmende dorëheqjen, kam një lehtësi jashtëzakonisht të madhe, besoj nga kushdo tjetër; nuk kam luftuar asnjë ditë të jetës sime për ta pasur këtë post. Dhe nuk kam asnjë brengë, asnjë çast në jetën time për ta lënë atë në mënyrën më dinjitoze. Por, atë e gjykoj unë", - tha Lleshaj.




**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerja e suportit vjetor te produkteve Cisco"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 5,466,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerja e suportit vjetor te produkteve Cisco"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 07 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje letër fashetimi, shirit plastik, lidhëse sigurie e plasmas, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,518,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje letër fashetimi, shirit plastik, lidhëse sigurie e plasmas, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 09 Maj 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

SPIUNËT
DOSJET

Zbardhet lista me emrat e agjentëve, sot titullarë në institucionet shtetërore

# Raporti në Kuvend, 30 zyrtarët që bashkëpunuan me ish-Sigurimin

## Nga Akademia te ministri, ja ku gjenden bashkëpunëtorët

Më shumë se 30 zyrtarë kanë rezultuar të kenë qenë agjentë ose bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit. Të dhënat janë zyrtare të Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të përfshira në raportin vjetor për 2018-ën, që ky institucion ka dorëzuar në Kuvend. Siç raportohet në këtë raport, gjatë dy viteve të para të funksionimit të këtij institucioni janë hasur rreth 30 zyrtarë apo kandidatë të tjerë që kanë rezultuar se në të shkuarën kanë qenë pjesë e strukturës famëkeqe të diktaturës, ose në rastin më të mirë të tyre, kanë qenë bashkëpunëtorë. "Në ushtrim të veprimtarisë sonë gjatë këtyre dy viteve kanë rezultuar gjithsej 30 persona pozitivë (figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit kryesisht b.p) nga të cilët, në konkretizim të sa më sipër, 13 rezultojnë pozitivë (figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit) vetëm për vitin 2017, ndërsa pjesa tjetër u përket rekordeve të vitit 2018", - thuhet në raport. Autoriteti thekson se ka verifikuar figura qendrore me peshë dhe rëndësi në jetën politike të vendit, si Presidenti i Republikës, Anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (Vetingu), anëtarë të KLGJ-së, anëtarë të KLP-së, gjeneralë, Avokati i Popullit, anëtarë të KQZ-së, anëtarë të Akademisë së Shkencave, prokurori i përgjithshëm i Përkohshëm. Gjithashtu, Autoriteti thekson se nisur nga detyrimi i procesit të vetingut ka verifikuar 294 kandidatë, prokurorë e gjyqtarë, apo edhe kandidatët për anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor nga të cilët 5 individë figurojnë dhe të ketë dokumentacion në dosjet e ish-Sigurimit. Me kërkesë nga Prokuroria e Përgjithshme është bërë verifikimi i figurës për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.


Kreyetarja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Gentia Sula

"Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimin nr.12, që ka të bëjë me subjektin e verifikuar (B.SH), për të cilin ka rezultuar se figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit", thuhet gjithashtu në raport, duke lënë të kuptohet se bëhet fjalë për anëtarin e KLP-së, Bujar Sheshi. Gjithashtu, bëhet e ditur se me kërkesë të dy partive politike Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Aleanca Popullore për Drejtësi janë verifikuar 285 persona në kuadër të verifikimit të figurës për kandidatë për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë për zgjedhjet e 25 qershorit. Nga ky verifikim ka rezultuar se 4 persona ishin në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (XH.A, R.T., F.T. dhe Z.G.). Në Ministrinë e Brendshme, Autoriteti ka verifikuar 30 persona përpara emërimeve ose të ngritjes në detyrë. Ky institucion ka dalë me një vendim, ku 1 person figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (A.XH.). Ndërsa me kërkesë nga Akademia e Shkencave janë verifikuar të gjitha kandidaturat në kuadër të verifikimit të figurës përpara emërimeve ose ngritjes në detyrë. Nga verifikimi, Autoriteti thotë se 2 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (Gj.Sh., I.M.). Në lupën e Autoritetit janë përfshirë edhe punonjës të Fakultetit Ekonomik, ku janë verifikuar 116 persona. "Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendim se 2 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (A.M. dhe I.K.)", - thuhet në raport. Ndërsa në Ministrinë e Jashtme, Autoriteti ka konstatuar se 7 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit. Nga verifikimi, Autoriteti ka dalë me vendimet për zyrtarët me inicialet F.R., E.M., Ll.K., J.Sh., G.S., A.A dhe A.D. Për verifikimin e figurës së punonjësve ka bërë kërkesë edhe Shërbimi Informativ Shtetëror, ku janë verifikuar 45 persona. Nga gjysma e procesit të realizuar nga këto punonjës rezulton se tre persona janë punonjës të ish-sigurimit të Shtetit. Kontrolle mësohet se janë kryer edhe në pushtetin vendor. Me kërkesë nga Garda e Republikës janë verifikuar 7 persona në kuadër të verifikimit të figurës dhe 1 person figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (Q.P.). Me kërkesë nga Kuvendi i Shqipërisë janë verifikuar kandidaturat në kuadër të verifikimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për anëtarë në Këshillin Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar nga të cilët 1 person (P.P.) figuron i regjistruar si bashkëpunëtor në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit.

## Betohen 3 deputetë të rinj opozitarë, Kuvendi me 102 anëtarë



Kuvendi i Shqipërisë është shtuar dje me 3 anëtarë të rinj opozitarë. Ata janë Halil Jakimi, Arlind Çaçani dhe Korab Lita. Bashkë me ta, numri i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë arrin në 102, nga të cilët 79 janë të mazhorancës dhe 23 të opozitës. Ndërkohë që deputeti i ri i opozitës, Korab Lita, që pranoi që të merrte mandatin nga listat e Partisë Demokratike pas betimit ka mbajtur fjalën e parë në Kuvendin e Shqipërisë. Ai tha se ashtu si demokratët që protestojnë jashtë, edhe ai kërkon largimin e qeverisë, por duke e luftuar nga brenda. Pavarësisht kritikave dhe akuzave të forta ndaj qeverisë, ai tha se është gati që të bashkojë votat me shumicën e drejtuar nga Edi Rama, nëse do të miratojë ndryshimin e ligjit zgjedhor. "Ju keni shumicën falë votave të blera dhe të marra me presion. Mund të qeshni se këto fjalë nuk kanë asgjë të re. Unë do të mundohem të sjell prova si dje ku i keni vjedhur votat. Pas çdo proteste mbushni qelitë me njerëz të pafajshëm. Shqipëria ka një sistem që legjitimon sistemin e njëshit. Ky sistem për fat të keq është miratuar me marrëveshjen e të dyja palëve. Unë deri dje isha në protestë, mund të isha sërish atje, po vendosa që luftën ta bëj nga parlamenti. Pas konsultimit me të gjithë njerëzit e mi në Kamëz vendosa që të jem në parlament. Ata që protestojnë jashtë janë miqtë e mi dhe duan që qeveria të largohet sa më shpejt. Sot ka mijëra socialistë që dëshirojnë largimin tuaj. Ju duhet të ndryshoni ligjin zgjedhor. Unë deklaroj se do të bashkoj votën me ju nëse do të ndryshoni ligjin zgjedhor. Do i hapej rruga përfshirjes në jetën publike të personave me integritet të lartë. Do të bashkoj votën me ju nëse ndryshoni sjelljen me votën. Kuvendi duhet të miratojë ligjin zgjedhor dhe më pas të shpërndahet", - tha ai. Ndërkohë që një tjetër kandidate për nga radhët e Partisë Demokratike ka dorëzuar formularin e dekriminalizimit në KQZ. Bëhet fjalë për kandidaten e PD-së në Gjirokastër, Florjana Dhimitri, e cila ka dorëzuar formularin e dekriminalizimit pranë Komisionit Qendror Zgjedhor, ku pritet të kërkojë edhe mandatin e deputetit.

### RAPORTI/ LISTA E ISH-SPIUNËVE NË ÇDO INSTITUCION

- Në organet e larta të sistemit të drejtësisë 5 individë kanë rezultuar të figurojnë dhe të kenë dokumentacion. 3 persona janë në ish-Sigurimin e Shtetit, 2 persona si subjekte proceduese ish-gjyqtar dhe ish-prokuror në procese penale politike (N.S., F.L.) dhe 1 person si bashkëpunëtor (S.V.).
- 1 kandidat, me inicialet K.J. për anëtar në KLP, rasti është në proces gjyqësor.
- Subjektin e verifikuar B.SH., anëtar i KLP, figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit, çështja është në gjyq.
- Ministria e Jashtme, 7 persona. Autoriteti ka dalë me vendimet për zyrtarët me inicialet F.R., E.M., Ll.K., J.Sh., G.S., A.A dhe A.D.
- Në Ministrinë e Brendshme, 1 person figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit (A.XH.).
- Në SHISH, 3 persona me inicialet K.P., Q.D dhe R.M.
- Nga lista e PDIU dhe Aleanca Popullore 4 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit: XH.A., R.T., F.T. dhe Z.G.
- Në Akademinë e Shkencave 2 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit, Gj.Sh. dhe I.M.
- Në Fakultetin Ekonomik të UT, 2 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit, A.M. dhe I.K.
- Në pushtetin vendor 2 raste, D.H.S dhe Z.K. figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit.
- Në Gardën e Republikës 1 person me inicialet Q.P. figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit
- Avokati i Popullit, 1 person S.N. figuron në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit.
- 1 kandidat për anëtar të KD në Radio Televizionin Shqiptar me inicialet P.P. ka dalë si bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit.


**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më date 26.04.2019 ora 8ºº - 16ºº në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-rë për shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi të Z.Shpëtim Barjam Boci:
- Truall me sipërfaqe 2863 m², Nr.pasurie 88/16, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 107 ndodhur në Jorgucat Gjirokastër, me vlerë fillestare në ankand 68,712 (Gjashtëdhjet e tetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë ) EURO
- Truall me sipërfaqe 2317 m², Nr.pasurie 88/25, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 121 ndodhur në Jorgucat Gjirokastër, me vlerë fillestare në ankand 55,608 (Pesëdhjet e pesëmijë e gjashtëqind e tetë) EURO
- Truall me sipërfaqe 790 m², Nr.pasurie 88/23, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 119 ndodhur në Jorgucat Gjirokastër, me vlerë fillestare në ankand 18,960 (Tetëmbëdhjet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjet) EURO
- Truall me sipërfaqe 780 m², Nr.pasurie 88/20, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 111 ndodhur në Jorgucat Gjirokastër, me vlerë fillestare në ankand 18,720 (Tetëmbëdhjet mijë e shtatëqind e njëzet) EURO
- Truall me sipërfaqe 1750 m², Nr.pasurie 88/18, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 109 ndodhur në Jorgucat Gjirokastër, me vlerë fillestare në ankand 42,000 ( Dyzet e dy mijë ) EURO

**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

"Turp, turp o plehra! E provofshi te fëmijët tuaj, do të vendosim vetë drejtësi"

# Vrasja e Marvi Mihalit, gjykata dënon me 55 vite burg 4 të rinjtë

## *Shpërthejnë prindërit e viktimës: Sot djalit i ka lëvizur pllaka e mermerit sipër varrit*

TIRANË

Gjykata e Tiranës ka dënuar me 55 vite burg në total katër të rinjtë, të cilët në korrik të vitit 2017 vranë me thikë 22-vjeçarin Marvi Mihali. Pas një sërë seancash gjyqësore, dje togat e zeza të kryeqytetit vendosën dënimin me 19 vjet heqje lirie Dejvi Bitrajn, i cili pohohet të jetë personi që goditi për vdekje të riun Mihali, ndërsa për kushëririn e tij, Eugen Bitraj dha 12 vite burg. Gjithashtu, trupi gjykues vendosi dënimin me nga 12 vite burg në mungesë për vëllezërit Kridens dhe Marsel Alla. Këta dy të fundit janë ende në kërkim, pasi nuk janë arrestuar nga policia për ngjarjen e rëndë që tronditi kryeqytetin. Mësohet se gjykata e Tiranës vendosi të rikualifikojë veprën penale nga "Vrasje me paramendim", në "Vrasje me dashje". Ndërkohë që prokuroria kishte kërkuar 87 vjet në total për 4 të rinjtë. Marvi Mihali u vra pas një përleshje mes të rinjve për një karikues më 31 korrik të 2017-ës. Nga hetimet e kryera rezultoi se Mihali u godit me thikë dhe ndërroi jetë për shkak të plagëve të marra pas një konflikti për një karikues telefoni mes një mikut të tij dhe Dejvi Bitrajt. Sherri palëve ndodhi në afërsi të stadiumit "Selman Stërmasi". Ndërsa, Bitraj pretendon se e ka kryer vrasjen për shkak se Mihali e ka fyer. Sipas të pandehurve, Mihali e ka ofenduar Bitrajn dhe ky i fundit ka kryer vrasjen. Nga ana tjetër, vendimi i dhënë ditën e djeshme ka pasuar me reagimin e ashpër të prindërve të viktimës, të cilët kanë kërkuar dënim maksimal, në të kundërt kanë paralajmëruar vetëgjyqësi. Duke mallkuar gjykatësit, ata u shprehën se nuk do t'i ndahen drejtësisë sa të kenë jetë.

**REAGIMI I PRINDËRVE TË VIKTIMËS**

"S'kam kam kërkuar asgjë, vetëm drejtësinë, të cilën kam thënë që do ta vendos me çdo kusht. Sot djalit tim i ka lëvizur pllaka e mermerit sipër varrit. Sa të kem jetë, të gjithë ata që janë përlyer në këtë histori të ndyrë do të marrin reston e vet. Unë nuk do të ndaloj së kërkuari drejtësi, kjo është tallje. Ai e theri, ia nguli thikën nga lart mbi shpinë, e rrëzuan tinëz, që nuk kishin asnjë punë dhe ai ndryshon kualifikimin e veprës penale, heq paramendimin, e lë vetëm vrasje në bashkëpunim me dashje, që të abuzojnë me vendimin. Siç duket, këta gjykatës nuk kanë frikë as nga vetingu, ose e dinë që janë në rreth, të futur në rreth dhe tani të përfitojnë çfarë munden. Nuk i bëhet vonë se vdiq djali im. Fatin tim të zi e provofshin gjykatësit në fillim, e provofshin fatin tim të zi! Kaq kam për të thënë", tha nëna e të ndjerit. Ndërsa, babai i viktimës, Pavllo Mihali deklaroi: "Turp për Sokol Tonen, turp për Tan Gjermenin, turp për Besnik Hoxhën! Mallkimi i djalit tim i ndjektë këta gjykatës, këta plehra. Si e ndërrojnë kualifikimin e veprës këta? Këtu të gjitha faktet të pastra si kristali. Ç'është kjo drejtësi?! Unë do them vetëm një gjë, padrejtësia e gjykatësve sot lëvizi pllakën e djalit tim. Por, ne do ta ndjekim këtë me çdo kusht, unë do ta vendos drejtësinë me të gjitha mënyrat. 19 vjet për Dejvi Bitrajn që ma vrau çunin, e masakruan me shkelma dhe 19 vjet… nga 12 i dënuan këta të tjerët, turp e faqe e zezë! Ky është mjerimi i drejtësisë. Turp, faqja e zezë për këta gjykatës plehra".



22-vjeçari i vrarë, Marvi Mihali



Prindërit e viktimës



Autorët e krimit në gjykatë

**DËNIMET E DHËNA NGA GJYKATA E TIRANËS PËR KATËR TË AKUZUARIT**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Dejvi Bitraj | 19 vite burg |
| 2. | Eugen Bitraj | 12 vite burg |
| 3. | Kridens Alla | 12 vite burg |
| 4. | Marsel Allaj | 12 vite burg |

**BABAI I VIKTIMËS**

"Turp për Sokol Tonen, turp për Tan Gjermenin, turp për Besnik Hoxhën! Mallkimi i djalit tim i ndjektë këta gjykatës, këta plehra. Si e ndërrojnë kualifikimin e veprës këta?! Këtu të gjitha faktet janë të pastra si kristali. Ç'është kjo drejtësi? Unë do them vetëm një gjë, padrejtësia e gjykatësve sot lëvizi pllakën e djalit tim. Por ne do ta ndjekim këtë me çdo kusht, unë do ta vendos drejtësinë me të gjitha mënyrat. 19 vjet për Dejvi Bitrajn që ma vrau çunin, e masakruan me shkelma dhe 19 vjet… nga 12 i dënuan këta të tjerët, turp e faqe e zezë. Ky është mjerimi i drejtësisë. Turp, faqja e zezë për këta gjykatës plehra", u shpreh në gjyq Pavllo Mihali.

**NËNA E VIKTIMËS**

"Sot djalit tim i ka lëvizur pllaka e mermerit sipër varrit. Sa të kem jetë, të gjithë ata që janë përlyer në këtë histori të ndyrë do të marrin reston e vet. Unë nuk do të ndaloj së kërkuari drejtësi, kjo është tallje. Ai e theri, ia nguli thikën nga lart mbi shpinë, e rrëzuan tinëz dhe ai ndryshon kualifikimin e veprës penale, heq paramendimin, e lë vetëm vrasje në bashkëpunim me dashje që të abuzojnë me vendimin. Siç duket këta gjykatës nuk kanë frikë as nga vetingu, ose e dinë që janë të futur në rreth dhe tani të përfitojnë çfarë munden. Fatin tim të zi e provofshin gjykatësit në fillim", tha ndër të tjera nëna e viktimës.

Mallkimi i djalit tim i ndjektë këta gjykatës, këta plehra. Si e ndërrojnë kualifikimin e veprës këta? Këtu të gjitha faktet të pastra si kristali. Ç'është kjo drejtësi?! Unë do them vetëm një gjë, padrejtësia e gjykatësve sot lëvizi pllakën e djalit tim. Por, ne do ta ndjekim këtë me çdo kusht, unë do ta vendos drejtësinë me të gjitha mënyrat. 19 vjet për Dejvi Bitrajn që ma vrau çunin, e masakruan me shkelma dhe 19 vjet… nga 12 i dënuan këta të tjerët, turp e faqe e zezë! Ky është mjerimi i drejtësisë. Turp, faqja e zezë për këta gjykatës plehra".

## SHKURT

### Digjet makina "Ford" e shefit të Krimeve

**TEPELENË** - Makina e shefit të Krimeve në Tepelenë, Gentjan Shehut, u përfshi nga flakët në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Burime nga policia lokale bënë me dije se ngjarja ndodhi rreth orës 05:00 në lagjen "15 Shtatori" të këtij qyteti. Mësohet se automjeti ishte parkuar poshtë pallatit ku banon Shehu. Paraprakisht dyshimet janë se automjeti u përfshi nga flakët për shkak të një defekti elektrik, megjithatë policia po heton edhe për një zjarrvënie të qëllimshme. "Në datën 11.04.2019, rreth orës 5:00, në lagjen '15 shtatori', Tepelenë, është djegur në pjesën e përparme mjeti tip 'Ford', në përdorim të shtetasit G.Sh.. Në vendngjarje shkoi grupi hetimor dhe nga hetimet e para procedurale rezultoi se shkaku i djegies së mjetit është aksidental", njoftoi policia.

### Organizonte lojëra fati në lokal, procedohet 28-vjeçari

**DURRËS** - Një 28-vjeçar me iniciale D.Z. është proceduar penalisht për aktivitetin e paligjshëm të lojërave të fatit. Sipas policisë, shtetasi në fjalë, banues në fshatin Luz, Fushë-Krujë ushtronte aktivitet e paligjshëm të lojërave të fatit në lokalin e tij. Ndër të tjera, sipas policisë mësohet të jenë sekuestruar tavolinë pokeri dhe fishë-bixhozi. Po të njëjtat burime pohuan se kontrollet kundër aktivitetit të lojërave të fatit do të vijojnë deri në ndëshkimin e subjektit të fundit që ushtron këtë aktivitet antiligjor.

## Shpërthim me tritol në lokalin e ish-portierit të Flamurtarit, shoqërohen 8 persona



**VLORË** - Një shpërthim me tritol ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të sotëm në qytetin e Vlorës. Ngjarja ka ndodhur pranë një lokali rreth orës 03:35 në lagjen "Ril-indja". Nuk raportohet për të lënduar, por vetëm dëme materiale. Sipas policisë, shpërthimi ka ndodhur në lokalin me pronar S.Z. dhe po hetohet për të zbuluar autorët. Pas ngjarjes, në qytetin bregdetar janë zbuluar detaje të reja. Mësohet se lënda plasëse, e cila mendohet rreth 200 gr ka qenë e vendosur ne hyrjen e një lokali, pronë e ish-portierit të Flamurtarit, Servet Zyberi. Kanë qenë banorët e pallatit pranë këtij biznesi, të cilët kanë lajmëruar policinë dhe zjarrfikësen. Policia ka nisur menjëherë hetimet për ngjarjen dhe ka marrë në pyetje Servet Zyberin dhe djalin e tij. Babë e bir kanë deklaruar se nuk kanë konflikte me asnjë person, rrjedhimisht as dyshime se kush mund të jenë autorët e mundshëm. Deri më tani, policia ka shoqëruar në komisariat 8 persona. Policia po heton gjithashtu probleme personale të djalit të ish-sportistit.

## Ish-deputetit socialist, Arben Ndoka i sekuestrohen pasuritë me vlerë 40 milionë euro

**TIRANË** - Prokuroria e Krimeve të Rënda ka sekuestruar pasurinë e ish-deputetit të PS-së, Arben Ndoka, i cili u arrestua në tetor të vitit 2018 në kuadër të operacionit "Volvo 4", si i përfshirë në një skemë tjetërsimi pronash. Burime nga organi i akuzës bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare" se sipërfaqet ndodhen në vende si: "Mali i Rrenzit", Shëngjin, "Rana e Hedhun", Laguna e Lezhës si dhe disa apartamente në plazh dhe kanë një vlerë


Ish-deputeti socialist, Arben Ndoka

rreth 40 milion euro. Mësohet se i janë sekuestruar 300 mijë metër katror tokë në bregdetin e Lezhës dhe apartamente, me vendim të gjyqtarit Bib Ndreca. Prokurorët e çështjes te Krimet e Rënda janë: Vladimir Mara dhe Dritan Prençi, thuhet në njoftim e Krimeve të Rënda. Nga përgjimet telefonike të prokurorisë, Arben Ndoka rezultonte i përfshirë në një skemë tjetërsimi pronash në zonën e Kunes dhe Rana e Hedhun në Shëngjin. Gjithçka u zbulua nga hetimet e prokurorisë për vëllain e Arben Ndokës, Gjevi Ndoka, si i lidhur me grupin e Avdylajve të Shijakut, të cilët akuzohen për trafik droge dhe porositës të heroinës së laboratorit të Hasit. Pronat ishin përfituar në mënyrë të paligjshme me anë të falsifikimit. Tashmë, me vendim gjykate Arben Ndoka ndodhet në masën e sigurisë "arrest shtëpie". Në operacionin "Volvo 4" u goditën 4 grupe kriminale, mes të cilëve edhe ata të fisit Avdylaj në Shijak, si dhe ish-drejtori i burgjeve, Arben Çuko.

### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, Vate Staka miratohet si anëtar në KLP

# Zëvendësimi i Antoneta Sevdarit, përplasje mes Arta Markut dhe prokurorit Sokol Malaj

## *Kryeprokurorja: Dilni jashtë, mbledhjen e drejtoj unë*

**TIRANË**

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Prokurorëve është shoqëruar dje me debate të forta. Mësohet se mbledhja ishte thirrur nga kryeprokurorja Arta Marku për të bërë zëvendësimin e Antoneta Sevdarit, ish-anëtare e KLP-së, e cila u shkarkua më herët nga procesi i vetingut, ndërsa si kandidat është paraqitur emri i Vate Stakës. Përplasja ka qenë mes drejtueses së përkohshme të akuzës, dhe një pjese të trupës së prokurorëve. Konflikti u bë i dukshëm në mbledhjen e djeshme ku morën pjesë 230 prokurorë dhe ku 45 prej tyre kërkuan të ndryshohet rregullorja e votimit duke u bazuar në nenin 18 të të njëjtës rregullore të miratuar në dhjetor 2018. Kërkesa e një të dhjetës së prokurorëve u lexua nga prokurori Sokol Malaj dhe në të kërkohej se kur ka një kandidat të vetëm, ai të konfirmohej si anëtar i KLP-së vetëm nëse merrte më shumë se 50% të votave. Kërkesa nuk u pranua të hidhej në votim nga Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme, Arta Marku, çka solli përplasjen e hapur. Pas përplasjes së një grupi prokurorësh me kryeprokuroren Marku, mbledhja e asamblesë u ndërpre për disa minuta. Pasi rinisi mbledhja, kryeprokurorja Marku u shpreh se: "Konstatohet se ka kërkesë për ndryshim tip të fletës së votimit. Kjo flete votimi nuk mund të ndryshohet. Fleta e votimit ka vetëm një emër deri tani, gara ka qenë e hapur dhe mund të kishit kandituar. Propozimi është i ligjshëm, por ne kemi një praktikë të konsoliduar nga votimi i mëparshëm. Mendoj që mund të vazhdojmë me rendin e ditës, ankimi mund të behet brenda afateve. Nuk lejohen replikat". Pas saj, Prokurori Sokol Malaj ka marrë sërish fjalën duke kërkuar që propozimi i tij të hidhet në votë. "Të nderuar kolegë ne e dimë se zgjedhja duhet bërë mes disa kandidaturash. Ky është një parim kushtetues. Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme thotë me frymën e ligjit. Me kë frymë ligji? Ne duhet të hedhim propozimin në votë, dhe asambleja vendos", tha ai. Menjëherë është kundërpërgjigjur Arta Marku. "Kush nuk do të marrë pjesë në votim, të largohet. Pastaj ankimet bëhen në Gjykatën e Apelit. Dilni jashtë. Mbledhjen e


Kryeprokurorja Arta Marku, gjatë mbledhje së djeshme të Asamblesë




drejtoj unë", është shprehur kryeprokurorja. Ndërsa Malaj ka thënë se nuk mund t'i tregojë largimin prej mbledhjes. Në një klimë të tendosur, 135 votuan pro Vate Stakës si njeriu që do t'i përfaqësojë ata në KLP, ndërsa 81 u shprehën kundër. Anëtari më i ri i KLP-së zëvendëson Antoneta Sevdarin, që u shkarkua nga vettingu. Vate Staka është, gjithashtu, edhe kandidat për në SPAK, çka do të thotë se me shumë gjasë ai do të japë dorëheqjen nga kjo ambicie. Sidoqoftë, udhëtimi i tij drejt KLP-së vjen në një kohë kur së shpejti mbyllet gara për prokurorë të përgjithshëm dhe ku garuesit, mes tyre edhe Arta Marku bënë lëvizjet e tyre të radhës gjatë asamblesë.

### Sekretari i përgjithshëm, Gazment Bardhi, të hënën në prokurori

## Padia e Partisë Demokratike, nis hetimi për ministrin Lleshaj e policinë për dhunë në protestë

**TIRANË** - Prokuroria e Tiranës ka regjistruar një kallëzim penal ndaj ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj dhe Policisë së Shtetit. Regjistrimi i kallëzimit penal ka ardhur pas një padie të Partisë Demokratike në 18 mars. Në padinë e depozituar nga sekretari i përgjithshëm i PD, Gazment Bardhi, policia akuzohet për veprime në shkelje të ligjit. Sipas selisë blu, Policia e Shtetit ka shpërdoruar detyrën në protestat e zhvilluara nga 16 shkurti deri në 16 mars. Për Partinë Demokratike, përdorja e gazit lotsjellës dhe ujit me presion për të shpërndarë protestuesit është në shkelje të ligjit dhe tej kompetencave ligjore. Me këto veprime sipas PD-së, policia nuk ka pasur synim zbatimin e ligjit, por pengimin e zhvillimit të protestës. Mbi këto pretendime të Partisë Demokratike, Prokuroria e Tiranës ka regjistruar kallëzimin penal ndaj ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj dhe Policisë së Shtetit. Prokuroria pritet të hetojë mbi veprimet e policisë gjatë protestave të opozitës. Partia Demokratike thotë se, "siç tregojnë pamjet e ditës së protestës, jo vetëm nuk është respektuar, por qëllimi i policisë ka qenë pengimi i zhvillimit të protestës, duke hedhur mjete të helmimit masiv dhe ujë me presion ndaj të gjithë protestuesve, jashtë rregullave dhe rrethanave të lejuara nga ligji. Ky



është rasti i parë ku prokuroria nis hetimet ndaj veprimeve të Policisë së Shtetit për përdorimin e gazit lotsjellës dhe ujit me presion ndaj protestuesve. Prokuroria do të hetojë nëse Policia e Shtetit ka tejkaluar kompetencat e saj dhe nëse ka ushtruar dhunë jo proporcionale ndaj protestuesve", thuhet në njoftimin e selisë blu. Gjithashtu, në organin e akuzës është thirrur për të dhënë sqarime të mëtejshme edhe sekretari i përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi. Ai pritet të paraqitet në Prokurorinë e Tiranës të hënën në orën 12:00, pas thirrjes nga oficeri i policisë gjyqësore.

### SHKURT

#### Largohet drejtori i policisë, Qato

**ELBASAN** - Drejtori i Policisë së Elbasanit, Altin Qato është larguar dje nga posti, ndërsa në vend të tij është emëruar Arjan Muça. Kjo lëvizje vjen në kuadër të rritjes së sigurisë në këtë qytet. Drejtori i ri, Arjan Muça është një emër i njohur për publikun. Ai ka qenë drejtuesi i njësisë operacionale gjatë arrestimit të Dritan Dajtit në 7 gusht 2009 në Durrës, teksa mbetën të vrarë katër policë. Ndërkohë Altin Qato ishte në krye të policisë së Elbasanit për dy vite. Para se të merrte këtë post në policinë e Elbasanit, Qato mbante detyrën e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Pas vrasjes së avokatit, Ravik Gurra në Elbasan dhe ekzekutimit të dy vëllezërve Bilali në Shkodër, drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu paralajmëroi se do të ketë ndryshime në Elbasan dhe në Shkodër.

#### U kapën duke vjedhur, arrestohen dy të rinjtë

**SARANDË** - Dy të rinj janë arrestuar në Sarandë, pak pasi u kapën duke vjedhur. Sipas policisë, të arrestuarit janë shtetasit F.K. 19 vjeç dhe A.Q. 18 vjeç, të cilët u arrestuan pasi u kapën në flagrancë në lagjen nr.3 Sarandë duke vjedhur një magazinë. "Shërbimet e policisë Sarandë kanë bërë arrestimin e këtyre dy shtetasve pasi janë kapur në flagrancë në lagjen nr.3 Sarandë, duke vjedhur magazinën e shtetasit L.M. Materialet iu referuan prokurorisë në ngarkim të tyre për veprën penale "Vjedhje e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë", -njoftoi policia.

ARRSH: Mbikëqyrja e punimeve në lotin 2. KPP pranoi ankesat e operatorëve

# Anulohet tender tjetër i "Unazës"

## *Dy ankesa për komisionin e Prokurimit Publik*

Vijon anulimi i tender ave për ndërtimin e "Unazës së Madhe". Autoriteti Rrugor Shqiptar vendosi të anulojë një tjetër procedurë tenderuese për ndërtimin e këtij vepre. Bëhet fjalë për mbikëqyrjen e punimeve në lotin 2 të këtij segmenti, një tender me vlerë 10.7 milionë lekë. Sipas ARRSH-së, arsyet e anulimit lidhen me faktin se asnjë nga ofertat e paraqitura nuk ka arritur të marrë minimumin e pikëve për propozimin teknik, ndërsa nga ana tjetër, edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur anulimin e procedurës. Sipas dokumenteve të tenderit, mësohet se për këtë procedurë tenderuese vetë kompanitë pjesëmarrëse në garë kanë depozituar 2 ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankesa e parë është depozituar nga kompania "A&E Engineering" sh.p.k në datën 27 dhjetor 2018, ndërsa në datën 31.12.2018 edhe kompania 'IKN' ka vendosur t'i drejtohet KPP-së për të njëjtin tender të zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**VENDIMI**

Me vendimet për anulimin nga ana e KPP-së konfirmohet problematika që ka ekzistuar edhe në këtë tender. Ndërtimi i "Unazës së Madhe" u përfshi në skandalin e kompanisë "DH Albania", e cila arriti të shpallej fituese e 18 mln eurove me dokumente të falsifikuara, ndërkohë që projekti është kundërshtuar gjerësisht nga banorët që preken nga ndërtimi, të cilët vijojnë prej muajsh protestat e pandërprera. Vetëm dy muaj më parë, në 31 janar të këtij viti, kryetarja e ARRSH, Sonila Qato në nja dalje për mediat njoftoi se janë skualifikuar të gjitha ofertat e paraqitura për lotin e parë e të "Unazës së Re". Qato u shpreh se ofertat e paraqitura nuk plotësojnë kriteret e kërkuara, ndërsa punimet në lotet e tjera të projektit do të vijojnë normalisht. "Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u ka ofruar të gjitha kompanive skualifikimin e ofertave të paraqitura, pasi nuk përputhen me kriteret. Do i paraqes ministres Balluku një proces transparent. Kompanitë janë partnere të ARRSH-së dhe dialogu dhe transparenca do jetë parësore. Kompanitë kanë të drejtën të ankimojnë. Në lotët e tjera të projektit do të vijojnë punimet dhe shpronësimet, pasi ky projekt do të realizohet", - tha Qato për mediat. Kujtojmë se pas zbulimit të skandalit nga emisioni "Të Paekspozuarit" në "News 24", ARRSH pezulloi ndërtimin në lotin e parë tek "Unaza e Re". Ky falsifikim e ka ndihmuar kompaninë "Dunwell Haberman" të fitonte lotin prej 18 milionë euro të tenderit për rindërtimin e "Unazës së Madhe", duke krijuar imazhin e rremë se kjo është një kompani 20-vejçare dhe me eksperiencë në projektet e infrastrukturës. E vërteta është se kjo kompani është themeluar në 25 qershor 2018, vetëm dy muaj përpara zhvillimit të tenderit.



Faqja në Internet www.arrsh.gov.al

1. Lloji i procedurës: "Sherbim Konsulence"
2. Numri i Referencës: REF-86052-09-17-2018
3. Objekti i kontratës "Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrrotullimi Shqiponja Loti 2"
4. Fondi limit; 10 691 597,64 pa TVSH
5. Arsyet e Anulimit:
Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 24, pika 1:
a) ;
b) ;
c) ;
ç) ; Asnjë nga ofertat e paraqitura ne fazen e dyte nuk ka arritur te marre minimumin e pikeve për Propozimin Teknik (70 pike),
d) ;
dh); Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.170/2019, datë 26.03.2019 ,pika 2, ka vendosur anullimin e procedures.
Etj.
6. Informacione shtesë

**PROCEDURA**

Sipas dokumenteve të tenderit, mësohet se për këtë procedurë tenderuese vetë kompanitë pjesëmarrëse në garë kanë depozituar 2 ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

## Kuvendi, Konkurrencës: Monitoroni kontratat, kujdes me katër tregje!

Autoriteti i Konkurrencës do të duhet ta ndalë fokusin e tij gjatë këtij viti te monitorimi i kontratave koncesionare, si dhe një sërë tregjesh të rëndësishme, që kanë qenë pjesë e hetimeve apo monitorimeve edhe më herët. Në rezolutën që vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2018, Kuvendi i Shqipërisë e ngarkon këtë institucion me një sërë detyrash, të cilat duhet të mbahen parasysh. Kështu së pari, Kuvendi rendit si më të rëndësishme për Konkurrencën, monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në tregjet e hetuara gjatë vitit 2018 e veçanërisht për kontratat koncesionare në fuqi, që sjellin deformime të konkurrencës në treg, duke evidentuar dhe përllogaritur dëmin apo përfitimin real të konsumatorit publik. Së dyti, është kërkuar që të mbikëqyret dhe të dilet me rekomandime konkrete për tregjet me sensitivitet të lartë publik e ndikim social si: tregu bankar, tregu i shërbimeve spitalore dhe tregu farmaceutik, si dhe sektori i arsimit të lartë publik dhe privat. E njëjta rezolutë vlerëson se ka nevojë për rishikim të legjislacionit, duke e përafruar atë me pjesën e Bashkimit Europian.


PRIMALL

Rr.Ibrahim Rugova
Pallati Kontakt nr.10, kati 4
1000 Tirana, Albania
t. +355 44 500 909
f. +355 44 500 910

info@primall.al www.primall.al

Shoqeria **PRIMALL shpk** , distributor I autorizuar per Shqiperine e markave te kompanise nderkombetare "JT International", njofton mbi cmimin e produkttit te ri qe do tregetohet duke filluar nga data **15/04/2019** i cili eshte si me poshte

| Marka | Cmimi perfundimtar me date 15 Prill (TVSH e perfshire) |
|---|---|
| Winston XStyle Silver Long | 230 |

Njoftimi behet ne perputhje me udhezimin Nr.6 date 30/01/2015 te Ministrise se Financave "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"( i ndryshuar)



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 09 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

| Nr | Përshkrimi i Produktit | Çmimi prej datës 09.04.2019 (përfshirë TVSh-në) |
|---|---|---|
| 1 | HEETS (AMBER LABEL) | 320 Lekë/paketë |
| 2 | HEETS (BRONZE LABEL) | 320 Lekë/paketë |
| 3 | HEETS (TURQUOISE LABEL) | 320 Lekë/paketë |
| 4 | HEETS (YELLOW LABEL) | 320 Lekë/paketë |

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar'" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk
Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, lista me pronarët që marrin paratë për truallin

# Tokat e zëna, 620 pronarë përfitojnë kompensimin

## Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë e Vlorë

Qeveria ka miratuar kompensimin financiar të pronarëve që preken nga ndërtimet informale. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në Tiranë Jug, Kamëz-Vorë, Vlorë, Elbasan, Lezhë, Durrës, Shkodër, Tiranë Veri dhe Tiranë Shtesat, që përfshijnë në kompensim 620 pronarë. Në vendim përcaktohet se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga Agjencia e Kadastrës, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë të përfituesve së bashku me shumën për çdo pronar. Për kompensimin e pronarëve përdoren të ardhurat që arkëtohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtimit të Pronës. Pronari plotëson një kërkesë për kompensimin në vlerë sipas formatit tip, që vihet në dispozicion nga ATP-ja. I interesuari duhet të paraqesë dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie. Një tjetër dokument është vërtetimi i lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare, ku do të transferohet vlera financiare e përfituar. Qeveria urdhëron Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përkatësisht në Elbasan, Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

### PRONARËT QË PËRFITOJNË KOMPENSIMIN

OSMAN ZENEL TAÇE
MONDI OSMAN TAÇE
LUAN OSMAN TAÇE
OSMAN ZENEL TAÇE
HATIXHE SHAHIN TOÇILA
SELIM SHAHIN DERVISHI
ZADE SHAHIN LAMI
HAVA SHAHIN XHEPEXHIU
LULJETA SHAHIN KUMRIA
HAJRIE DERVISHI
ENEIDA RAMAZAN DERVISHI
ENXHI RAMAZAN DERVISHI
TAIBE SHAHIN DERVISHI
KADRI SHAHIN DERVISHI
ENGJELLUSHE SHAHIN DUZHA
BAJAME DALIP DERVISHI
NEXHMIE DALIP BEQIRI
AGIM DALIP DERVISHI
FATOS DALIP DERVISHI
FLORA DALIP HYSA
MANUSHE DERVISHI
SUZANA HAJDAR ÇEKREZI
FATMIR HAJDAR DERVISHI
ANILA HAJDAR DERVISHI
LILJANA HAJDAR DERVISHI
HURMA DERVISHI
ZHULJETA MUSA BALLIU
ARDJANA DERVISHI
KLEJVI AGRON DERVISHI
XHORXHINA AGRON DERVISHI
ELIDA MUSA DERVISHI
BRUNILDA MUSA BAJRAMI
KLODIANA MUSA JAUPI
BEJAZE TARE TATA
TRANE OSMAN DISHA
PERPARIM SULEJMAN DISHA
SHQIPE SULEJMAN DISHA
MAJLINDA SULEJMAN DISHA
LLAMBI STAVRI JORDANI
LIVAN QOSJA
MYZEJEN KRASNIQI
FATIME KRASNIQI
SKENDER KRASNIQI
ISMETE KRASNIQI
BEDRIJE KRASNIQI
QEMAL KRASNIQI
XHEVAHIR KRASNIQI
IKBAL QOSJA
TOMORR QOSJA
RASIM QOSJA
HAXHIRE QOSJA
LUIZA QOSJA
ILIRJAN QOSJA
AGRON QOSJA
LLAMBI SIMON BULI
VEZIKO HEKURAN HASA
HIDAJETE VEHBI GARUNJA
DALLANDYSHE VEHBI ISUFAJ
MIMOZA VEHBI HASA
ELENI VEHBI MAVRAQI
SHQIPE VEHBI SELIMAJ
ENKELEJDA VEHBI MUSAJ
NAILE VEHBI HASA

IBRAHIM TOPTANI
LILJANA SHERIF SHTINO
ILONA VASIF ZISO
VIVIANA PETRIT TOPTANI
QAMIL HYSEN BIÇAKU
GJINOVEFA MUSTAFA BIÇAKU
NERAIDA HYSEN TAUSHANI
LUM-MIR SHERIF FRASHERI
RITA SHERIF FRASHERI
MEHMET SEBAUDIN DERVISH BIÇAKU
AHMET SHYQERI DERVISH BIÇAKU
EVELINA PETRIT QYQJA
SEFEDIN SHYRI BIÇAKÇIU
REFIK PETRIT TOPTANI
SAIDE PAJOVA
ZYBA MUSAJ
FATMIR BESNIKU(KOPILI)
ENGJELLUSHE IBRAHIM
SHENGJERGJI
ZYHRA GRECA
MAKBULE ZENELHOXHA
HYSEN VELENICA
HIQMETE LABINOTI
EDISON VELENICA
SHEFQET TUXHARI
ILIRJANA STAFA
MARIA JORGO
ARTUR MEZINI
KRENAR MEZINI
SAIDE PAJOVA
ZYBA MUSAJ
FATMIR BESNIKU(KOPILI)
ENGJELLUSHE IBRAHIM
SHENGJERGJI
ZYHRA GRECA
MAKBULE ZENELHOXHA
HYSEN VELENICA
HIQMETE LABINOTI
EDISON VELENICA
SHEFQET TUXHARI
ILIRJANA STAFA
MARIA JORGO
ARTUR MEZINI
KRENAR MEZINI
SAIDE PAJOVA
ZYBA MUSAJ
FATMIR BESNIKU(KOPILI)
ENGJELLUSHE IBRAHIM
SHENGJERGJI
ZYHRA GRECA
MAKBULE ZENELHOXHA
HYSEN VELENICA
HIQMETE LABINOTI
EDISON VELENICA
SHEFQET TUXHARI
ILIRJANA STAFA
MARIA JORGO
ARTUR MEZINI
KRENAR MEZINI
SAIDE PAJOVA
ZYBA MUSAJ
FATMIR BESNIKU(KOPILI)
ENGJELLUSHE IBRAHIM

SHENGJERGJI
ZYHRA GRECA
MAKBULE ZENELHOXHA
HYSEN VELENICA
HIQMETE LABINOTI
EDISON VELENICA
SHEFQET TUXHARI
ILIRJANA STAFA
MARIA JORGO
ARTUR MEZINI
KRENAR MEZINI
THEMISTOKLI BEBI
MAKBULE QAZIM BALA
MUSA MUSTAFA XHEPA
ISMET RIZA XHEPA
NURI RIZA XHEPA
ILIRIANA MUSA BASHA
LUAN SULEJMAN STRINGA
XHEMAL QAZIM XHEPA
REZAR RIZA XHEPA
AIDA MAUSA MEÇA
RAJMONDA VELI KASMI
ZENEPE QAZIM ZALLA
OMER AZMI STRINGA
ARBEN AGRON STRINGA
ERVIN MUSTAFA LAMÇJA
GLADIOLA AGRON
STRINGA(DAKLI)
LILJANA MUSTAFA
LAMÇJA(BIÇOKU)
LUMNIJE ZIJA LUNIKU(MUÇA)
MERITA MUSTAFA
LAMÇJA(DURO)
PRANVERA AZMI
HAMZAJ(STRINGA)
VJOLLCA ZIJA LUNIKU
BENON MUSTAFA LAMÇJA
BRIKENA SEZAI
HAXHIADEMI(BAXHAKU)
ALEMSHA AZMI BOLLANO(STRINGA)
DALIP KADRI BAKALLI
FATUSH BAKALLI
NASHIFER BAKALLI
MELEQ BAKALLI
KADESHE BAKALLI
MUSA BAKALLI
SHEJNAZ BAKALLI
BURBUQE BAKALLI
DRITAN SADIK ÇENGELI
MAHMUD DALIP XHANI
AMARILDO AGRON ZABELI
KEIDA AGRON ZABELI
KLEVIS AGRON ZABELI
SHPETIM NAZMI SKILJA
TOMOR YMER SAMARXHIU
AVNI YMER SAMARXHIU
LIVIA KASTRIOT ZABELI
LEDIO KASTRIOT ZABELI
KASTRIOT HYSNIZABELI
BUJAR HYSNIZABELI
EGLANTINA HYSNI ZABELI
SHPRESA HYSNIZABELI
ARJANA HYSNIZABELI

PLATON HYSNIZABELI
ELIDA HYSNIZABELI
FERDINANT SULEJMAN MURATI
HATIXHE SULEJMAN KAFEXHIU
VIOLLCA SULEJMAN DHEFTO
DASHAMIR(ZIJA) RIZA LUNIKU
ELISABETA SURJA XHIXHA
FLORA RAMAZAN BALZA
HYQMET RIZA LUNIKU
MILI(XHEMILE) RIZA LUNIKU
SHAZIME MUSTAFA LUNIKU
SURJA SHERIF XHIXHA
ERVIN MUSTAFA LAMÇJA
LILJANA MUSTAFA
LAMÇJA(BIÇOKU
LUMNIJE ZIJA LUNIKU(MUÇA)
MERITA MUSTAFA
LAMÇJA(DURO)
VJOLLCA ZIJA LUNIKU
AHMET HAJDAR ISAJ
LINDITA SURJA XHIXHA
ABDURRAHMAN LUNIKU
BENON MUSTAFA LAMÇJA
SEIT LUNIKU
SELIM LUNIKU
NEXHATIJE QAFA
SHAQIR RIZA LUNIKU
FERIT BEHXHET LUNIKU
SYPHIJE BEHXHET DYLGJERI
KUME LUNIKU
BASHKIM BEHXHET LUNIKU
BURBUQE HAJDAR SHTRAZA
VJOLLCA HAJDAR SELITA
HATIXHE HAJDAR BAJRAKTARI
LINDITA KUJTIM AGOLLI
BESA KUJTIM ISAJ
VALTER ZEQIRHOXHA
PRANVERA ALUSH BALZA
IKBAL ALUSH BALZA
ENGJELLUSHE ALUSH BALZA
FIQIRI ALUSH BALZA
ROVENA AGIM BALZA
ARLIND AGIM BALZA
HILMIJE KRYPA
FATOS LUNIKU
LAVDIJE DOMI
SAMI BEHEXHET LUNIKU
SUZANA MUSTAFA LUNIKU
ALFONC NUREDIN LUNIKU
AGIM NUREDIN LUNIKU
ANI KUJTIM HOXHA
MERLIN NEXHDET HOXHA
ANILA KUDRET HOXHA
AFERDITA YMER
HASEQIU(HAXHIMUSAJ)
AGIM YMER HAXHIMUSAJ
ANILA MUSTAFA KATRO(SHOPI)
BURBUQE STRUGU
FERDINAND STRUGU
FLORINDA FUGA(STRUGU)
HATIXHE MUSTAFA
SHOPI(KARKANAQE)
HEDIJE YMER HAXHIMUSAJ

### Hyn në fuqi vendimi i qeverisë, ja si ndahet fondi 2.39 miliardë lekë

# Pensionet/ Hyn në fuqi shtesa për çdo kategori, llogaritjet për 659 mijë përfitues

## *Pensionet e pleqërisë dyshemeja 15 403 lekë*

Hyn në fuqi rritja e pensioneve në masën 2. 8 %. Janë në total rreth 650 mijë pensionistë që do të përfitojnë rritje të pensionit nga tre qind deri në shtatë qind lekë në muaj. Fondi që do të shkojë për shtesën e pensioneve gjatë gjithë vitit 2019 është 2.39 miliardë lekësh. Vendimi i qeverisë është botuar dje në fletoren zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

**RRITJA**

Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore përveç rritjes me 2.8%, do të përfitojnë edhe kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit", me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë: a) deri në 15 403 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, b) deri në 14 903 lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare; c) deri në 10 108 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare. Kompensimet për të ardhura mujore minimale nisin nga 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 403 lekë në muaj. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përllogariten në shumën 2,4 miliardë lekë dhe përballohen nga fondi për politikat e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2019, të cilat ndahen: a) 2. 3 miliardë lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve; b) 14 milionë lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare, sh.a.

**VENDIMI**

Qeveria vendosi indeksimin në masën 2.8 për qind për 16 kategori pensionesh dhe përcaktoi kufirin minimal dhe maksimal për pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.4.2019 e në vazhdim dhe përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993. Sipas vendimit, mësohet se përfitojnë rritje pensionet e caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", pensionet sociale. Shtesë mujore në masën 2.8% do të përfitojnë edhe personat që trajtohen me mbrojtje të veçantë të ushtarakut, pensionet suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë". Rritje në masën 2.8% do të përfitojnë edhe rastet e trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar dhe nr.9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar dhe rastet e trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension". Rritja do të aplikohet për personat që trajtohen me pagesa të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë"; pensionet suplementare të caktuara sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë". Në pikën dy të vendimit të Këshillit të Ministrave përcaktohet se indeksimin e pensionit e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.3.2019, përfshirë edhe këtë datë.


Foto ilustruese

**PENSIONET**

**1.** Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr.150/2014, që kanë datë fillimi të së drejtës deri më 31.12.2014, pas datës 1.4.2019 nuk do të jenë më pak se 13 753 lekë në muaj dhe më shumë se 27 506 lekë në muaj.

**2.** Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.4.2019 nuk do të jenë më pak se 9 418 lekë në muaj, por jo më shumë se 13 753 lekë në muaj.

**3.** Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.4.2019 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 13 753 lekë në muaj.

### Largimet e padrejta nga puna

## KMSHC: 311 gjyqfitues në 2018, institucionet nuk e zbatojnë



Rreth 311 nëpunës të administratës civile kanë fituar gjyqet dhe kërkojnë rikthimin në punë, por pjesa më e madhe e institucioneve nuk i zbaton vendimet e formave të prera të gjykatave. Në raportin vjetor për vitin 2018, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se nëpunësit mbeten ende në pritje, megjithëse kanë në dorë një vendim gjykatë që detyron institucionet t'i rikthejnë në pozicionin e punës nga i cili janë larguar. Në total, numri i vendimeve gjyqësore për të larguarit nga puna për vitin e shkuar është 477, ndërkohë që 166 prej tyre kanë marrë përgjigje, me dëmshpërblim apo rikthim në punë. Sipas raportit mësohet se në institucionet e administratës shtetërore qendrore dhe ato të varësisë 32% (ose 100 raste) e nëpunësve gjyqfitues, janë rikthyer në pozicione të rregullta të shërbimit civil, ndërsa 68% (209 raste) e tyre janë ende në pritje për t'u rikthyer në pozicione pune në shërbimin civil. Ndërkohë, në institucionet e vetëqeverisjes vendore, në kategorinë e bashkive, në 61 institucione dhe 12 Këshillat e qarqeve janë rikthyer në pozicione të rregullta të shërbimit civil, ose janë dëmshpërblyer 41% (62 raste) e nëpunësve gjyqfitues, ndërsa 59% (90 raste) e tyre janë ende në pritje për ekzekutimin e vendimit.

### Miratohet javën e ardhshme Karta e Studentit

## Veliaj: Janë aprovuar 40 shërbime publike

Në mbledhjen e qeverisë javën e ardhshme pritet të miratohet VKM-ja për Kartën e Studentit. Këtë e ka bërë të ditur kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, gjatë një takimi të zhvilluar në Qytetin Studenti në godinat 28-29, ku ishte i pranishëm edhe kryeministrit, Edi Rama. Sipas Veliaj, Këshilli Bashkiak ka aprovuar edhe 40 shërbimet publike nga të cilat studentët do të mund të përfitojnë zbritje pas pajisjes me këtë kartë. "Kryeministrit javën tjetër ka për vendim në tavolinën e vet në mbledhjen e qeverisë VKM-në për Kartën e Studentit. Është përgatitur. Kryeministri e ka vënë në rendin e ditës për të mërkurën. Menjëherë sapo të mbarojë mbledhja e kryeministrit në do të bëjmë një dëgjesë për të bërë prezantimin e kartës. Tashmë Këshilli Bashkiak i Tiranës i ka aprovuar dhe 40 shërbimet, ca janë kinema, ca janë teatër, ca janë abone student dhe gjëra të kësaj natyre që mund të kenë më shumë impakt. Të 40 shërbimet janë "shërbime publike", u shpreh Veliaj. Ndërkohë, ndërsa ka njoftuar se kanë shfaqur interes po ashtu edhe kompani prive për të ofruar shërbime për studentët me kosto më të ulët, ka shtuar se do të punohet që shpërndarja e kartave të përfundojë para mbylljes së viti akademik, pra brenda datës 21 korrik. "Ndërkohë, duke qenë se kemi filluar të flasim për kartën janë ofruar dhe shumë kompani private, kryesisht që sheshin libra, rroba. Kështu që do të fusim edhe shërbime private. Ne do të mundohemi që të shpërndajmë sa më shumë deri më 21 korrik."


BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.
MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET
INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID
BalkanWeb.com
BW
FALAS

Rrëfehet reperi: E vërteta e deklaratës për Feron, kënga e radhës do jetë "bombë"

# Klajdi Zenullari:

## Bashkëpunimet me artistët e mëdhenjtë më dhanë art

*"Secili e di drejtimin e tij më mirë se askush tjetër"*





Egla Xhemali

Ai është artist i ri, por mjaft i talentuar në zhanrin e tij. Në një intervistë për "Gazeta shqiptare" Klajdi Zenullari, apo siç njihet në muzikë si KMC, flet për mënyrën si e sheh muzikën, bashkëpunimet që i sollën suksesin, mendimin e tij për reperët shqiptarë e shumë e shumë të reja nga jeta e tij profesionale. Ata që e duan artin e sidomos muzikën kanë premisa për të shkëlqyer në çdo kohë. Me punë realizohet gjithçka. Ajo i kapërcen limitet e parashikuara për të ndërtuar një aureolë të merituar, që koha nuk do ketë fuqi ta zbehi. Një rrëfim ndryshe i një artisti të ri që ka potencial për të sjellë një frymë të re. Ai preferon ta quajmë KMC dhe kështu po e bëjmë!

**KMC ke kohë që je pjesë e muzikës, por vetëm dy vitet e fundit ke bërë "boom" në muzikë, ke pritur momentin e duhur apo bashkëpunëtorët e duhur?**

Faleminderit për intervistën në fillim! Mendoj se gjithçka vjen me kohën, gjithçka që ke ambicie të realizosh ka të bëjë me përkushtimin, me eksperiencën me synimet, janë shumë gjëra bashkë që duhet të ndërthuren për të arritur tek synimi. Është e vërtetë që këto dy vitet e fundit ka qenë "boom-i" im edhe pse unë kam shumë vite që bëj muzikë dhe që jam pjesë e muzikës. Kanë qenë bashkëpunëtorët, që më kanë dhënë një dorë për të ecur, por ndoshta ka qenë edhe moment im.

**Bashkëpunime me Blerina Matrakun, me Antre, me Aurel Thëllimin, çfarë ke marrë ti nga këto bashkëpunime? Çfarë u ke dhënë ti atyre?**

Kam marrë art prej tyre, art të cilin ata e kanë bërë dhe e kanë fituar prej kohësh sepse janë emra big në muzikë dhe unë i falënderoj që më kanë pranuar ftesat apo edhe realizuar këto bashkëpunime. Unë i kam dhënë ndoshta frymën e artistit të ri, ndoshta panë tek unë veten vite më parë kur nisën edhe ata të këndonin, dashurinë që kam unë për muzikën dhe përkushtimin ndaj saj. Kanë qenë bashkëpunime të suksesshme dhe këtë e kanë treguar edhe vlerësimet e publikut pas çdo bashkëpunimi të publikuar.

**Ndonjë këngë solo ke në plan të publikosh?**

Sigurisht që po, unë kam një këngë solo që e kam sjell vjet me titull "Bring it on" që ka pasur sukses dhe u prit mirë, e patjetër që jam në përgatitje për lançimin e një tjetër këngë solo, por pse jo edhe një bashkëpunim tjetër.

**Ke ndonjë emër konkret?**

Për momentin nuk mund ta them, por besoj se shumë shpejt do zbulohet! (qesh)

**KMC, çfarë gjen ti në botën e repit që i ke hyrë kaq me themeli?**

Gjej jetë, muzika që bëj unë është art dhe arti është jetë, besoj se përmblidhen të gjitha në këtë që thashë!

**E shikon veten pa muzikë apo ajo do ishte jetë pa kuptim?**

Ç'është ajo fjalë, mos e thënë Zoti…!

**Mes dy reperëve të famshëm botërore do doje të ishe si Eminem apo si 50 cent?**

Eminem është mbreti dhe këtë nuk e luan topi.

**Kohët e fundit po qarkullon një deklaratë në të cilën je pyetur nëse do bëje një bashkëpunim me reperin e ri Fero dhe je përgjigjur që ai s'ka talent, por para. Vazhdon ti qëndrosh këtij mendimi?**

Ohh, akoma me këtë muhabet? (qesh) Të jemi realist, ai mund të ketë patur suportin e duhur, por talent? Gjithsesi, secili e di drejtimin e tij më mirë se askush tjetër!

**Kush ka talent sipas teje në Shqipëri?**

Të talentuarit, ata që as ti as unë nuk ia heqim dot meritën dhe që fatkeqësisht janë shumë pak.

**Të mbeti ndonjë merak pa thënë?**

Më prisni dhe më mbështesni në këngën e radhës, do jetë "bombë"..!

**Në fund do doja të jepje mesazhin tënd për muzikën në përgjithësi dhe repin në veçanti?**

Duajeni muzikën dhe bëni muzikë nga shpirti dhe për shpirtin!







# Mos ka gjë mes tyre? Dhurata Dora dhe reperi i famshëm "fotografohen" në një hotel

Nuk ka shumë kohë që Dhurata Dora dhe reperi algjerian, Sool King, lajmëruan bashkëpunimin e tyre nëpërmjet një video në 'Instagram'. Lajmi u prit shumë mirë nga fansat e tyre, të cilët ishin të emocionuar për këtë projekt, por para disa ditësh, dikush publikoi këngën e plotë të tyre dhe po qarkullon kudo në media. Pas kësaj, këngëtarja dhe reperi vendosën të heqin nga 'Instagram-i' videot ku dëgjohej vetëm refreni i këngës, për ta publikuar atë të plotë kur videoklipi të jetë gati. Pavarësisht kësaj, duket se kënga është pritur shumë mirë nga fansat dhe me siguri do të kthehet në hitin e verës. Xhirimet për videoklipin kanë nisur e këtë e ka zbuluar Soolking me foton e fundit në 'Instastory'. Reperi ka zbuluar se ai dhe Dhurata po xhirojnë në një hotel në Tiranë. Më shumë detaje nuk bëhen ende të ditura.




# "Je dërrasë!" / Zbuloni përgjigjen epike të super modeles

Ish-modelja shqiptare, Emina Cunmulaj, prej vitesh jeton në Amerikë me familjen e saj. Bukuroshja është mjaft aktive në rrjetet sociale, ku nuk nguron të flasë dhe me fansat herë pas here. Në foton e fundit në 'Instagram', Emina mori disa komente negative nga ndjekësit e saj, të cilët i komentonin format e saj trupore. Këtyre komenteve, ajo ka vendosur t'i kthejë përgjigje nëpërmjet një 'live'.

Fillimisht ajo është shprehur me shaka, duke thënë: "Në foton time të fundit në 'Instagram' lexoja disa komente që më thonin 'je dërrasë'. Po pse të shkon syri aty ku nuk duhet?". Më pas një nga ndjekëset e saj i shkruajti: "Më mirë dërrasë, sesa të shohësh operacione". "Unë jam shumë e kënaqur me trupin tim. Kështu më fali zoti dhe më pëlqen. Shyqyr zotit, kam edhe burrin që i pëlqen, kështu që, mos u shqetësoni", ia ka kthyer Emina.






# Elita tregon momentet qesharake kur i jep gji të birit

Elita Rudi është një ndër moderatoret më të njohura shqiptare dhe së fundmi i është dedikuar plotësisht djalit të saj, Zërit. Gjiko dhe Elita po gëzojnë një romancë të lumtur dhe lidhjen e tyre e forcoi më shumë lindja e djalit. Pak kohë më parë, moderatorja zbuloi se të voglin e saj e ushqen me qumësht gjiri dhe se kjo ishte edhe një nga arsyet që nuk rrinte dot larg tij. Teksa, shijon ndjenjën e bukur të mëmësisë, Elita ndan me fansat e saj momente të bukura me të birin. Ajo, së fundmi ka vendosur të rrëfejë pak sesi ndihet në këtë moment të jetës së saj.

Duke bërë shaka, Elita ka publikuar në "Instastory" një nga ato meme-t e famshme. Në mënyrën më qesharake, ajo tregon sesi duket dhënia e gjirit për nënën dhe për fëmijën. Në momentin që fëmija ushqehet me qumësht gjiri, nëna sheh një fytyrë të ëmbël engjëllore, por nuk mund ta themi të




# Ledri pohon se do të bëhet baba, ja çfarë ka për t'i thënë Arbana dhe Xhemi

Ledri Vula në një intervistë të fundit deklaroi se ka shumë dëshirë të bëhet baba dhe është i gatshëm për këtë."Jam shumë i gatshëm të krijoj familje. Si mund mos të jem i gatshëm kur shoh shokët e mi me fëmijë, si pëllumba. Unë luaj me fëmijët e tyre si t'i kem të mitë. Kur i shoh rrethin shoqëror që janë bërë prindër, them edhe unë dua."-u shpreh Ledri në NIN.Kjo deklaratë u pëlqye shumë nga fansat e tij dhe jo vetëm, kështu që dy moderatoret e njohura Arbana Osmani dhe Xhemi Shehu, nuk kanë nguruar që të "urojnë" reperin. Në një postim në 'Instastory' Arbana ka publikuar një video ku shihet me Xhemin në makinë duke dëgjuar këngën "That's mine" të Ledrit dhe Gashit. Në një moment Arbana pyet Xhemin se nuk e kupton se çfarë halli ka."Të urojmë Ledrin se do të bëhet baba!"- përgjigjet Xhemi, ndërkohë që situata krijon shumë të qeshura.





### Maqedoni e Veriut, nis verifikimi i adresave të 'gylenistëve'

# Në kërkim të terroristëve, hapen dosjet për ekstradimin e anëtarëve të "FETO"

Shqyrtimi i dosjeve të shtetasve të Turqisë në Maqedoninë e Veriut, po vazhdon rrjedhën, pas kërkesës së Ankarasë zyrtare për ekstradimin e këtyre personave që, sipas autoriteteve turke, dyshohet se kanë lidhje me organizatën e ashtuquajtur "FETO",kanë thënë zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë e Maqedonisë së Veriut. "Për momentin, kemi 15 kërkesa për ekstradimin e personave të caktuar Turqi. Të gjitha këto procedura janë në rrjedhë, për çka institucionet përkatëse janë në komunikim permanent", kanë bërë të ditur nga dikasteri i drejtësisë. Institucionet në Shkup nuk japin detaje për identitetin e personave, për të



cilët Turqia kërkon që të ekstradohen, megjithëse theksojnë se asnjë person nga kjo listë nuk është shtetas i Maqedonisë së Veriut. Ndërkohë, nga Ambasada e Turqisë në Shkup kanë theksuar se në mesin e personave që Ankaraja zyrtare kërkon të ekstradohen, ka dhe drejtues të institucioneve arsimore, përfaqësues të mediave në gjuhën turke, si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritarë që veprojnë në Maqedoninë e Veriut. Njohësit e çështjeve juridike theksojnë sistemi i drejtësisë në Maqedoninë e Veriut, duhet të jetë transparent për këtë proces, duke respektuar normat juridike ndërkombëtare dhe jo dëshirat e elitave politike të një shteti. "Nëse këta persona nuk kanë kryer veprime në shtetin përkatës ku ata gjenden, në rastin konkret në Maqedoninë e Veriut, do të thotë se këta persona janë të pafajshëm dhe në këtë rast shteti ynë mund ta vlerësojë vetë nëse këto veprime për çka akuzohen, janë ose jo të sajuara nga shteti që kërkon të ekstradohen". "Unë do të thosha se kjo çështje ka më shumë karakter politik ndërmjet dy shteteve, se sa argumente juridike, mbi bazë të së cilave kërkohet të bazohet ekstradimi", thotë Bashkim Selmani, ish-gjykatës, aktualisht ligjërues në Fakultetin Juridik të Tetovës. Ndryshe, gjatë javës së kaluar, ministri i Mbrojtjes i Turqisë, Hulusi Akar, ka kërkuar që Shkupi zyrtar të ndërmarrë veprime ndaj pjesëtarëve të lëvizjes "Hizmet", të klerikut Fetullah Gulen, të cilën Ankaraja zyrtare e konsideron si "organizatë terroriste të FETO-s". "E dimë që ekzistojnë struktura të caktuara të organizatës terroriste të FETO-s. Kemi edhe emra konkret të disa prej kryesorëve të këtyre strukturave, të cilat i kemi shkëmbyer me autoritetet e sigurisë në Maqedoninë e Veriut", kishte theksuar pas takimit me homologun e tij ministri turk i Mbrojtjes, Hulusi Akar. Pas këtij deklarate, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kishte deklaruar për mediat se institucionet përkatëse të shtetit, do të veprojnë në përputhje me Konventat Ndërkombëtare për ekstradim, si dhe me legjislaturën vendore.

### Greqia synon të blejë gjeneratën e re të avionëve luftarakë F35

Mbërthyer nga mosmarrëveshjet me Turqinë, e cila dëshiron të blejë gjeneratën e re të avionëve luftarakë Amerikanë F-35 të prodhuar nga Lockheed Martin, por, gjithashtu, të vendosë në territorin e saj sistemin rus anti raketor S400, Washingtoni po mendon që super avionët e saj të rinj t'ia shesë edhe Greqisë, Rumanisë dhe Polonisë. Aktualisht Greqia posedon linjën e avionëve luftarakë F16 që janë një model pak më i vjetër se F35. Raportohet se Greqia i ka dërguar letër korporatës amerikane ku kërkon të dijë çmimin për 25 deri në 30 avionë. Në një dëshmi me shkrim të paraqitur në Dhomën e Përfaqësuesve të SHBA, agjencia e lajmeve Reuters shkruan se nën-admirali Mathias Winter, kreu i zyrës së F35 në Pentagon tha se "klientët e ardhshëm potencialë përfshijnë Singaporin, Greqinë, Rumaninë, Spanjën dhe Poloninë". Ndonëse Greqia është përballur me krizë financiarë të rëndë, Athina në asnjë moment nuk i ka ulur investimet në ushtri dukë u renditur ndër të paktat vende të NATO-s që shpenzon 2 për qind të prodhimit të brendshëm bruto për mbrojtjen. Vendimi i SHBA për të pezulluar shitjen e super avionëve të saj luftarakë F-35 në Turqi i ka mundësuar Izraelit të ruajë epërsinë ajrore në Lindjen e Mesme, njoftoi Jerusalem Post. Izraeli posedon aktualisht 14 avionë të ndërtuar me porosi F-35 I Adir dhe pret të ketë 50 të tjerë deri në vitin 2024. Vitin e kaluar, Belgjika ishte klienti i parë i ri i gjeneratës së pestë të avionëve F-35, duke zgjedhur atë përballë avionit të ri luftarak evropian Typhoon. Korporata Lockheed Martin, kontraktori kryesor i avionit, po zhvillon dhe ndërton tre modele të avionëve të rinj për ushtritë amerikane dhe për 10 vende të tjera që kanë nënshkruar për të blerë avionët, siç është Britania e madhe, Australia, Italia, Turqia, Norvegjia, Holanda, Izraeli, Japonia, Koreja e Jugut dhe Belgjika. Ekziston frika se blerja e sistemit rus S400 nga ana e Turqisë mund t'i japë mundësi rusëve që të mësojnë pikat e dobëta të avionëve të rinj amerikanë F35. Presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan ka thënë se sistemet ruse për mbrojtje ajrore mund të arrijnë në Turqi më shpejt nga sa ishte planifikuar. Shtetet e Bashkuara i kanë kërkuar Ankarasë që të anulojë marrëveshjen me Rusinë duke thënë se sistemet ruse nuk janë në përputhshmëri me sistemet e NATO-s. Udhëheqësit e dy Komiteteve të Senatit amerikan, atij për Marrëdhëniet me Jashtë dhe tjetrit për Shërbime të Armatosura, kanë paralajmëruar Turqinë se rrezikon të përballet me sanksione të ashpra nëse vazhdon planet për blerjen e sistemit të mbrojtjes raketore S-400 të Rusisë.

### Franca dhe Gjermania ndërmjetësojnë, ç'do ndodhë në takimin e 29 prillit

# Samiti në Berlin, Thaçi dhe Haradinaj kundërshtojnë Vuçiç

## *Eksperti amerikan, Serwer: Ja kur mund të hiqet taksa*



Takimi që do bëhet në Samitin e Berlinit do të shfrytëzohet që të kërkohet liberalizimi i vizave, ka thënë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Ai thotë se në Berlin nuk do të kenë bilateral me president serb Vuçiç, por është një takim i përbashkët i kryeministrave dhe presidentëve të Ballkanit Perëndimor. Edhe presidenti Hashim Thaçi ka komentuar takimin e Berlinit duke thënë se nuk pret diçka konkrete në raportet mes Kosovës dhe Serbisë. Dy ditë më parë presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç tha se do të takohet në Berlin me Thaçin e Haradinajn ndërsa takimi është ndërmjetësuar dhe kërkuar nga Franca dhe Gjermania. Nga ana tjetër është diskutuar sërish rreth dialogut Kosovë-Serbi. Vendimi i serbëve nga veriu i Kosovës, të mbledhur rreth Listës Serbe, për të shkuar në zgjedhjet lokale mund të rifillojë dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës, tha Daniel Serwer, njohës i çështjeve të Ballkanit, njëherësh profesor në Universitetin Johns Hopkins në Uashington. Sipas tij, serbët në veri të Kosovës e kanë kuptuar se, nëse bojkotojnë zgjedhjet, atëherë ata nuk do të përfaqësohen në institucione, transmetojnë mediat serbe. Serwer sugjeron se vendimi për të marrë pjesë në zgjedhjet për institucionet në veri të Kosovës mund të ndikojë në vazhdimin e dialogut të bllokuar në mes të Beogradit dhe Prishtinës. "Natyrisht, nëse Prishtina tani përgjigjet duke pezulluar taksën ose diçka të tillë. Mund të jetë një hap në atë drejtim dhe shpresoj shumë për këtë", është shprehur Serëer. "Shpresoj se ideja e shkëmbimit të territorit të jetë gjithashtu e përjashtuar deri në momentin kur të dyja palët të kthehen në tryezën e bisedimeve", ka thënë ai. Ndërkaq sekretari amerikan i shtetit, Mathew Palmer ka reaguar para disa ditësh lidhur me kufirin Kosovë-Serbi. "Çështja e kufirit mes Kosovës e Serbisë, nuk është në qendër të marrëveshjes"- ka thënë Mathew Palmer, gjatë bashkëbisedimit me gazetarët në Tiranë. Ai tha se SHBA mbështesin Kosovën, ndërsa kërkoi nga Serbia ta njohë atë si shtet të pavarur e sovran. Gjithashtu, zyrtari amerikan theksoi se inkurajon palët në finalizimin e marrëveshjes mes dy shteteve. "E vërteta është që si SHBA dhe Gjermania e mbështesin Kosovën. SHBA nuk mbështet një rezultat të caktuar të procesit të negociatave; ajo që mbështesim është një marrëveshje midis Beogradit dhe Prishtinës që siguron normalizimin e plotë të marrëdhënies midis Serbisë dhe Kosovës. Besojmë që elementi qendror i kësaj duhet të jetë njohja e ndërsjellë, pra që Serbia njeh Kosovën si vend sovran dhe i pavarur dhe Kosova njeh Serbinë në të njëjtën mënyrë. Dhe mbi bazën e kësaj, të dy vendet e pavarura punojnë për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Çdo marrëveshje për normalizim të marrëdhënies është shumëdimensionale; do të ketë një element politik, një element ekonomik dhe tregtar, do të ketë edhe një element kulturor që do të marrë parasysh statusin e pronave të Kishës Ortodokse në Kosovë. Çështja e kufijve mund po ashtu të jetë pjesë e kësaj, por nuk është elementi kryesor i marrëveshjes sado që ta imagjinojmë këtë. Ajo që është e rëndësishme për SHBA është që çfarëdo marrëveshje të ketë pronësi vendase, të jetë diçka që të dyja palët ndjejnë se mund ta mbështesin, të dyja palët ndjejnë se mund ta shesin, të dyja palët besojnë se mbron interesat e tyre thelbësore, dhe ajo që kemi bërë ne është që i kemi nxitur palët të ulen në tryezë dhe të negociojnë marrëveshjen më të mirë që munden. Për aq sa SHBA është gati ta mbështesë atë marrëveshje, ne duam të na e sjellin, të na e tregojnë, ta shohim se çfarë është. Nëse kemi shqetësime për të, do t'i artikulojmë ato shqetësime dhe do të shohim nëse mund të gjejmë mënyra për t'i kapërcyer, por nuk po mbështesim ndonjë rezultat të caktuar apo ndonjë pjesë të caktuar përbërëse të asaj që, me përkufizim, do të ishte një diskutim i gjithanshëm, një marrëveshje e gjithanshme. E mbështesim këtë proces, mbështesim EEAS dhe BE në drejtimin e këtij procesi; nuk jemi palë në negociata por jemi palë në kuptimin që kemi interes në rezultatin e tyre pozitiv. Duam një zgjidhje që hap një rrugë europiane, një të ardhme europiane, si për Serbinë ashtu edhe për Kosovën, dhe jemi të përkushtuar që në partneritet me autoritetet në Kosovë si dhe me qeverinë në Serbi ta çojmë përpara atë synim." - u shpreh Palmer, në përgjigje të gazetarëve.

SHKURT

### Kurti: Nga Kosova nuk ikin kriminelët, por të ndershmit

Albin Kurti, kreu i Vetëvendosjes duke folur në parlamentin e Kosovës tha se nga Kosova nuk po ikin kriminelët, por njerëzit e ndershëm dhe prokurorët. Kurti përmendi rastin e ikjes së prokurorit Elez Blakaj, duke thënë se ai iku nga kryeministri dhe qeveria. Numri një i Vetëvendosjes u shpreh se emigrimi që po ndodh në Kosovë është për shkaqe të theksuara ekonomike. "Njerëzit ikin nga ky shtet, sepse iku edhe prokurori, si puna e Elez Blakajt, nga kryeministri dhe qeveria. Kosova është një vend prej nga nuk po ikin kriminelët, por po ikin prokurorët. Edhe ish-ambasadori amerikan Greg Delawie, më 15 gusht të vitit të kaluar pati thënë 'kemi parë frikësim të hapur politik dhe institucional përmes kërcënimeve dhe sulmeve personale kundër një prokurori, sjellje që vetëm mbështesin pohimet e tij për kërcënime dhe presione politike si arsye për dorëheqjen e tij. Kjo krijon mjedis armiqësor për cilindo prokuror apo gjykatës të ardhshëm'. Për t'i kthyer njerëzit ne duhet ta kthejmë njëherë Elez Blakajn",-tha ai. Albin Kurti theksoi se Kosova duhet që të forcojë sigurinë, rendin dhe sundimin e ligjit.

Akuzohej për ngacmim seksual, Assange kapet në ambasadën e Ekuadorit

# Arrestohet bashkëthemeluesi i Wikileaks në Britani

## Zëdhënësi rus: Shpreson që të drejtat e tij të mos shkelen

Julian Assange, bashkëthemeluesi i Wikileaks, është arrestuar këtë të enjte në Ambasadën Ekuadoriane në Londër. Assange u strehua në këtë ambasadë 7 vjet më parë, për të shmangur ekstradimin në Suedi, ku akuzohej për ngacmim seksual, një çështje që tashmë është pushuar nga autoritetet atje. Policia Metropolitane tha se Assange u arrestua pasi nuk iu dorëzua gjykatës. Ai kërkohej nga policia britanike pasi në Gusht të 2012-s, teksa ndodhej nën hetim nga Suedia, u la në liri me kusht nga gjykata pasi pagoi një garanci, por nuk u paraqit më para organeve të drejtësisë. Ndërkohë Presidenti i Ekuadorit, Lenin Moreno tha se e kishte refuzuar kërkesën e Assange për azil, për shkak të 'shkeljeve të vazhdueshme të konventave ndërkombëtare'. Vetë Wikileaks, me anë të një postimi në Twitter e cilësoi vendimin e Ekuadorit për të ndërprerë azilin politik të Assange të jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare. Ministri i Brendshëm britanik, Sajid Javid konfirmoi në një postim në Téitter se Julian Assange ishte arrestuar dhe se do të përballej me drejtësinë në Mbretërinë e Bashkuar. Ai falënderoi Ekuadorin për bashkëpunimin dhe policinë për profesionalizmin. "Askush nuk është mbi ligjin", shkruajti Javid. 47-vjeçari Assange kishte refuzuar që të largohej nga Ambasada Ekuadoriane, duke deklaruar se, nëse do të bënte një gjë të tillë do të ekstradohej në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për t'u marrë në pyetje për aktivitetet e WikiLeaks.


Julian Assange gjatë arrestimit në ambasadën ekuadoriane në Londër

Ndërkaq zëdhënësi i Kremlinit, Dmitri Peskov duke iu përgjigjur pyetjeve për arrestimin në Angli të themeluesit të Wikileaks Julian Assange, tha se Moska shpreson se të drejtat e tij nuk do të shkelen. Këtë të enjte, policia britanike arrestoi Assange brenda ambasadës ekuadoriane, shkruan agjencia e lajmeve TASS. Assange ishte fshehur në ambasadën e Ekuadorit në Angli që në vitin 2012. Assange është fshehur në Ambasadën e Ekuadorit në Londër që nga viti 2012, për të iu shmangur ekstradimin në Suedi ku akuzohej për sulme seksuale dhe pretendimet për përdhunimet e dy grave në vitin 2010. Prokurorët suedezë e liruan nga akuzat gjatë vitit të kaluar, por Assange ishte ende subjekt i një urdhër arresti britanik për shkelje të rregullave të lirimit me kusht në vitin 2012. Ai fillimisht u mirëprit në ambasadë, por pasi në Ekuador pati ndryshime në përbërjen e qeverisë, autoritetet filluan të reduktonin kontaktet e tij me të huajt dhe të zvogëlonin qasjen e tij në Internet. Presidenti i Ekuadorit, Lenin Moreno, tha se e tërhoqën azilin diplomatik për shkak të shkeljeve të përsëritura të konventave ndërkombëtare. Britania i ka dhënë Ekuadorit një garanci se themeluesi i Wikileaks nuk do të ekstradohet në ndonjë vend, ku mund të dënohet me vdekje, tha Presidenti Moreno. "Në përputhje me angazhimin tonë të fuqishëm për të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare, kam kërkuar nga Mbretëria e Bashkuar që të garantojë që Assange nuk do të ekstradohet në ndonjë vend ku mund të përballet me torturа ose me një dënim me vdekje",-tha Moreno në një video të postuar në Twitter. Ai shtoi se në përputhje me rregullat, qeveria britanike dha një garanci me shkrim, raporton Reuters. Sekretari i Jashtëm britanik, Jeremy Hunt, tha se Assange nuk është hero dhe se arrestimi i tij është rezultat i përpjekjeve shumëvjeçare të diplomacisë. Hunt, sipas Reuters, tha se për rastin e Assange do të vendosë sistemi ligjor britanik që është i pavarur. Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar ekstradimin e themeluesit të Wikileaks, Julian Assange, njoftoi policia britanike, duke e ndërlidhur arrestimin e tij edhe me këtë kërkesë të SHBA-së. Australiani 47 vjeçar, Julian Assange mund të përballet me proces gjyqësor për rrjedhjen e 500.000 dokumenteve të fshehta ushtarake të SHBA-së për luftërat në Afganistan dhe Irak.

**PRESIDENTI I EKUADORIT**
Presidenti i Ekuadorit, Lenin Moreno tha se e kishte refuzuar kërkesën e Assange për azil, për shkak të 'shkeljeve të vazhdueshme të konventave ndërkombëtare'. Vetë Wikileaks, me anë të një postimi në Twitter e cilësoi vendimin e Ekuadorit për të ndërprerë azilin politik të Assange të jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare.

## SHKURT

### Shtyhet afati i Brexit deri më 31 tetor

Shtyhet afati i daljes së Britanisë së Madhe nga Bashkimi Europian. Liderët e unionit i dhanë Londrës kohë deri më 31 Tetor, për zgjidhur mosmarrëveshjet për Brexitin. Kryeministrja britanike Tereza Mei kërkoi fillimisht shtyrje të afatit deri më 30 qershor, por Brukseli vendosi një afat edhe më të zgjeruar. Presidenti i Këshillit Europian, Donald Tusk u bëri thirrje deputetëve britanikë të mos humbin më kohë, por t'i japin zgjidhje përfundimtare kësaj çështjeje. Po ashtu, Londra duhet të përgatitet për zgjedhjet e majit për Parlamentin Europian. Nëse vendos të mos marrë pjesë, Britania duhet të largohet më 1 qershor pa marrëveshje.

### Grusht shteti në Sudan, arrestohen të gjithë anëtarët e qeverisë

Grusht shteti në Sudan, ku ushtria ka rrethuar me njerëz dhe mjete ushtarake pallatin presidencial, duke marrë, gjithashtu, edhe godinën e televizionit shtetëror. Ushtarët kanë njoftuar më pas krijimin e një qeverie tranzitore, ndërsa presidenti Omar Al Bashir ka dhënë dorëheqjen. Ky zhvillim ka ndodhur në ditën e pestë të manifestimeve, ku mijëra njerëz kanë zbritur në shesh, duke i kërkuar presidentit të bëjë një hap pas, pas 30 vitesh në pushtet. Të gjithë anëtarët e qeverisë janë arrestuar pas dorëheqjes së presidentit. Në pranga edhe nënpresidenti i National Congress Party, Ahmed Haroun, ish-nënpresidenti Ali Osman Taha dhe truproja e presidentit. Sipas Arab News aeroporti i Khartum është mbyllur. Manifestuesit që prej ditësh kanë protestuar në rrugë, po festojnë për rënien e Al Bashir.

### Dhjetë të vdekur në Rio de Janeiro pas përmbytjeve të mëdha

Është të paktën 10 bilanci i të vdekurve nga stuhia e fuqishme e shirave, e cila prej së hënës dhe deri dje ka goditur qytetin e Rio de Janeiro. Sipas Institutit Meteorologjik të Rio kjo ka qenë stuhia me e keqe e 22 viteve të fundit. Mes viktimave është edhe një gjyshe 63 vjeçare me mbesën e saj 6 vjeç, të cilat janë përpirë nga balta brenda një taksie në të cilën udhëtonin. Uji ka përfshirë zona të ndryshme të Jugut të Rio-s, ku janë edhe lagjet më të pasura të qytetit. Të shumta edhe skenat e shkatërrimit me pemë të thyera dhe makina të varrosura dhe të përmbytura nga uji. Mes dëmtimeve më të mëdha ka qenë pista e biçikletave Tim Maria, e ndërtuar përgjatë detit në lungo maren Avenida Niemeyer, e inauguruar gjatë Olimpiadës së 2016. Kjo është hera e katërt që struktura pëson shembje.

### Benjamin Netanjahu drejt një mandati të pestë në pushtet

## Kryeministri izraelit kryeson ndaj Gantz, Likud barazi votash me Bardh e Blu-të e qendrës

Kryeministri izraelit Benjamin Netanjahu është pranë marrjes së një mandati të pestë në pushtet, pasi rivali i tij kryesor Benny Gantz pranoi se nuk do të ishte në gjendje të formonte një qeveri koalicioni pas rezultatit të ngushtë në zgjedhjet parlamentare të së martës. Rezultatet tregojnë se partia e tij Likud ka marrë po aq vota sa edhe Partia Bardhë e Blu e qendrës, drejtuar nga ish-udhëheqësi ushtarak, Benny Gantz. Në kushtet kur asnjë parti nuk ka fituar shumicën për të qeverisur e vetme, formimi i një koalicioni do të jetë i nevojshëm. Likud dhe aleatët e saj mund të përfundojnë me rreth 65 vende në parlamentin prej 120 anëtarësh. Zoti Netanyahu u tha mbështetësve të tij se Likud kishte arritur një "fitore të jashtëzakonshme". Ai tha se koalicioni i tij i mundshëm do të ishte një qeveri e krahut të djathtë dhe premtoi se do të ishte "kryeministër për të gjithë". Komentet bien ndesh me thirrjen e tij drejtuar votuesve në ditët e fundit të fushatës kur ai tha se do të forconte bazën e tij konservatore, duke u zotuar të aneksojë vendbanime në Bregun Perëndimor. Një hap i tillë mund t'i jepte fund çdo shansi për të krijuar një shtet të pavarur palestinez krahas Izraelit. Zoti Gantz e quajti zotimin e zotit Netanjahut "të papërgjegjshëm". Ai tha se favorizon një "marrëveshje paqësore të mbështetur ndërkombëtarisht". Zoti Gantz tha se partia e tij është një forcë për bashkimin e Izraelit dhe tha se ishte koha për të rrëzuar zotin Netanyahu nga pushteti. Presidenti Donald Trump tha të mërkurën në Shtëpinë e Bardhë se rizgjedhja e kryeministrit izraelit Netanjahu është një shenjë e mirë për paqen. Nëse partia Likud do të formojë një koalicion qeverisës, zoti Netanjahu do të ketë shanse për t'u bërë udhëheqësi më jetëgjatë në pushtet, duke ia kaluar themeluesit të vendit, David Ben-Gurion. Por Netanyahu përballet, gjithashtu, me një hetim penal në vazhdim. Në pritje të seancës dëgjimore gjyqësore, Prokurori i Përgjithshëm i Izraelit ka thënë se ka në plan të padisë zotin Netanjahu për ryshfet, mashtrim dhe shkelje të besimit. Zoti Netanjahu e ka quajtur hetimin një "gjueti shtrigash", duke i bërë jehonë shprehjes së mikut të tij të ngushtë, presidentit Trump, i cili e përdorte atë për të përshkruar hetimin që po kryhej lidhur me fushatën zgjedhore të vitit 2016.


Kandidati për kryeministër i Izraelit, Benjamin Netanjahu

TRASHËGIMIA

Këshillat që "vulosin" çfarë është trashëgimi dhe si mbrohet tashmë kanë një rregullore funksionimi, por ata humbasin disa kompetenca.

# Qeveria miraton Këshillin e Trashëgimisë, kush i lejon e ndalon ndërtimet

*Rriten kompetencat e ministrit për PPP-të e njohura si rijetëzim, ç'ndodh me gërmimet*

*Vendimet merren me shumicë absolute të 15 anëtarëve, votimi i hapur*

Fatmira Nikolli

Qeveria ka miratuar me një VKM përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore jomateriale dhe të asaj materiale. Një VKM e tillë ka ardhur si nevojë pas miratimit të ligjit të ri të trashëgimisë vitin e kaluar. Ajo që vihet re është se shumë kompetenca i kalojnë ministrit, pasi këshilli këshillon dhe miraton, por në disa raste nuk merr vendim. Kjo bën që të jetë ministri që vendos për thembrën e Akilit, ndërtimet dhe rijetëzimet.

**KËSHILLI**

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (KKTKJ) është organ kolegjial vendimmarrës me 11 anëtarë: nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që e kryeson dhe 10 anëtarë që emërohen prej tij. Tek anëtarët përfshihen drejtori i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale (QKVT), përfaqësues të drejtorive për çështjet e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe nga në Instituti Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), një jurist dhe emra nga Instituti i Antropologjisë e personalitete të fushës së trashëgimisë në disiplinat e etnografisë, etnomuzikologjisë, organologjisë, etnokoreologjisë, folklorit apo menaxhimit të trashëgimisë kulturore jomateriale. Mandati i anëtarit të KKTKJ-së është 2 vjet, me të drejtë riemërimi. Anëtarët duhet të gëzojnë reputacion të lartë profesional, të jenë pjesë e sistemit të trashëgimisë dhe mundësisht nga bota akademike. Lirimi nga detyra bëhet kur ai nuk merr pjesë pa arsye në 2 mbledhje të njëpasnjëshme të KKTKJ-së, kur dënohet ose kur me veprimet a mosveprimet dëmtojnë veprimtarinë dhe emrin e KKTKJ-së. KKTKJ-ja mblidhet jo më pak se një herë në 6 muaj. Vihet në dukje se mbledhja e KKTKJ-së është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë me votim të hapur dhe nuk mund të abstenojnë. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale mbikëqyr veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore jomateriale, miraton në parim kërkesën për deklarimin e interesit kulturor, harton dhe miraton strategjinë dhe programe të zhvillimit në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale etj.. Mes të tjerash, propozon projekte dhe masat që duhen ndërmarrë për ruajtjen e mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale, sidomos atyre që janë në rrezik si edhe miraton programin e katalogimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore jomateriale, që realizohet në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore. Në vijim ky këshill miraton vlerat e trashëgimisë jomateriale kombëtare për regjistrim në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s si edhe "Kryevlerat Kombëtare" deri dhe te miratimi i listës përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s.



**TRASHËGIMIA MATERIALE**

Ndërkaq, vendimi më i rëndësishëm është ai për Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale. Më i rëndësishëm sepse nëse trashëgimia jomateriale zhbëhet nga moskudesi, ajo materiale zhbëhet nga interesa të mëdha. Edhe ky këshill është kolegjial, drejtohet nga ministri i Kulturës, por përbëhet nga 5 anëtarë, ku futen përfaqësues të Institutit të Trashëgimisë Kulturore, të Drejtorive të Trashëgimisë, të Institutit të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, juristi i ministrisë, personalitete të Arkeologjisë, personalitete të trashëgimisë me përvojë profesionale a akademike si dhe përfaqësues nga Universiteti i Tiranës.

**NDËRTIMET**

Ai harton akte të karakterit të përgjithshëm, me qëllim sigurimin e uniformitetit të vlerësimit të interesit kulturor dhe miraton e vlerëson planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore.

Mandati është dyvjeçar dhe kriteret janë si për këshillin e trashëgimisë jomateriale. Pranë këtij këshilli ka edhe një këshill teknik, organ kolegjial seleksionues, vlerësues e vendimmarrës, që ka në përbërje 7 anëtarë, të cilët janë pjesë e 15 anëtarëve të KKTKM-së. Këshilli teknik vepron si trupë shqyrtuese dhe seleksionuese e përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura pranë KKTKM-së. Këshilli teknik (me ligjin e vjetër - këshilli shkencor) ka kompetencë të miratojë kërkesa që lidhen me ndërhyrjet me karakter mirëmbajtje të pasurive kulturore, sipas listës së ndërhyrjeve të miratuara nga KKTKM-ja. Për çështje të tjera, që sipas parashikimeve të ligjit janë kompetencë e KKTKM-së, këshilli teknik, pasi shqyrton përputhshmërinë e kërkesave të paraqitura, miraton relacionin përkatës të hartuar nga sekretaria teknike dhe ia përcjell për vendim Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale. KKTKM-ja mblidhet jo më pak se një herë në 2 muaj. Mbledhjet zhvillohen gjithmonë në prani të kryetarit dhe janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të vendimeve për miratimin e lejes për ndërhyrje, për të cilën vendos me shumicë absolute. Vendimet merren me votim të hapur dhe anëtarët që janë të pranishëm në mbledhje nuk mund të abstenojnë. Kryetari, pra ministri voton i fundit dhe kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

**RËNDËSIA**

Pse është i rëndësishëm ky këshill? Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale licencon dhe u revokon licencën subjekteve, personave fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim, vlerësim, veprimtari arkeologjike, të arkeologjisë së shpëtimit dhe arkeologjisë nënujore. Ai miraton projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim. Njëherësh mbikëqyr veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit (pra jo vetëm tokën) dhe miraton lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme. Këshilli miraton në parim kërkesën për deklarimin e interesit kulturor, si edhe shpalljen e qendrave historike, të parqeve e zonave arkeologjike dhe zonat mbrojtëse të pasurive kulturore. Ai harton akte të karakterit të përgjithshëm, me qëllim sigurimin e uniformitetit të vlerësimit të interesit kulturor dhe miraton e vlerëson, planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore. Këshilli këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore gjatë shqyrtimit prej tij të kërkesave të subjekteve të veçanta për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në


https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-1

IV. Kompetencat e këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 38, të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", ka këto kompetenca:
a) Licencon dhe u revokon licencën subjekteve, personave fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim, vlerësim, veprimtari arkeologjike, të arkeologjisë së shpëtimit dhe arkeologjisë nënujore;
b) Miraton projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim;
c) Mbikëqyr veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit;
ç) Miraton lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe lejet e parashikuara në këtë ligj;
d) Miraton, në parim, kërkesën për deklarimin e interesit kulturor;
dh) Miraton, në parim, shpalljen e qendrave historike, të parqeve e zonave arkeologjike dhe zonat mbrojtëse të pasurive kulturore;
e) Harton akte të karakterit të përgjithshëm, me qëllim sigurimin e uniformitetit të vlerësimit të interesit kulturor;
ë) Miraton, vlerëson, në parim, planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore;
f) Këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore gjatë shqyrtimit prej tij të kërkesave të subjekteve të veçanta për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona me pasuri kulturore;
gj) Miraton dhe revokon lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike;
h) Miraton planet e zhvillimit, të projekteve restauruese e konservuese dhe projektet kërkimore-shkencore të njësive të administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike;
i) Miraton hulumtimet arkeologjike sistematike, me karakter kërkimor-shkencor, dhe hulumtimet arkeologjike parandaluese e të shpëtimit;
j) Miraton dhe revokon lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike nënujore;
ligjit nr.27/2018;
l) Këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim;
ll) Shprehet me vendim për kërkesat për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore, në përputhje me kompetencat e saj;
m) Shprehet lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe ndërmjet ... të huaja apo subjekteve të licencuara për kryerjen e veprimtarive ...
...imeve transformuese në territor, sipas nenit 134, të ligjit nr.27/2018;

VKM për Këshiillin e trashegimisë

## KOMPETENCAT

Është po ky këshill që duket se merr vendim për "PPP" e trashëgimisë që njihen si rijetëzim. Megjithëse në fakt, ky këshill këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim, shprehet me vendim për kërkesat për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore, në përputhje me kompetencat e saj miraton projektet e zhvillimeve transformuese në territor, miraton dhënien në përdorim, në formën e rijetëzimit, të pasurive kulturore të regjistruara si pasuri kulturore "me rëndësi kombëtare".

zona me pasuri kulturore dhe autorizon institucionet e specializuara a subjektet e licencuara për përdorimin e aparaturave metalkërkuese për kryerjen e gërmimeve me karakter arkeologjik. Ai miraton dhe revokon lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike, sikundër miraton planet e zhvillimit të projekteve restauruese e konservuese dhe projektet kërkimore-shkencore të njësive të administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike, miraton edhe: hulumtimet arkeologjike sistematike e ato parandaluese, lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike nënujore, etj.

## PPP-TË E TRASHËGIMISË

Është po ky këshill që merr vendim për PPP-të e trashëgimisë që njihen si rijetëzim. Kjo do të thotë se ky këshill këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim, shprehet me vendim për kërkesat për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore, në përputhje me kompetencat e saj, shprehet lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe ndërmjet institucioneve vendëse dhe të huaja apo subjekteve të licencuara për kryerjen e veprimtarive hulumtuese, miraton projektet e zhvillimeve transformuese në territor, miraton dhënien në përdorim, në formën e rijetëzimit, të pasurive kulturore të regjistruara si pasuri kulturore "me rëndësi kombëtare" dhe shprehet me vendim për verifikimin e interesit të veçantë publik të pasurive të peizazhit kulturor, madje edhe miraton projektet për ndërhyrje në pasuritë e peizazhit kulturor. Njëherësh, këshilli merr vendim për përcaktimin e distancave, të masave/hapësirave dhe variantеve të projektit në fazë ekzekutimi, të nevojshme për të siguruar ruajtjen e vlerave të pasurive të peizazhit kulturor si dhe ka çdo kompetencë tjetër, të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore. Këshilli teknik shprehet me vendim përfundimtar lidhur me kërkesat për ndërhyrjet me karakter mirëmbajtjeje. Llojet e ndërhyrjeve, sipas kësaj pike përcaktohen me vendim të KKTKM-së. KKTKM-ja shqyrton kërkesën për deklarimin e interesit kulturor ose për miratim, në parim, të vendimit për shpalljen e qendrave historike, të parqeve dhe zonave arkeologjike, mbi bazën e vendimit të komisionit këshillimor përkatës për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore. KKTKM-ja miraton dhe vlerëson në parim planet e përgjithshme e të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, si dhe lejet zhvillimore përpara miratimit të tyre nga organet kompetente, në bazë të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Aplikimet e nisura për shqyrtim dhe vendimmarrje nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (KKR) dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) trajtohen sipas akteve të krijimit të KKR-së dhe KKA-së, deri në ngritjen e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK).

REFORMA

# AKADEMIA E SHKENCAVE

# Reforma, depozitohet në Kuvend projektligji

Fatmira Nikolli

*Financohet nga buxheti i shtetit, por mirëpret sponsorizime*

Deputetët e Partisë Socialiste kanë depozituar në Kuvend projektligjin për reformën e Akademisë së Shkencave. Eglantina Gjermeni, Anastas Angjeli, Mimi Kodheli, Vilma Bello, Senida Mesi, Fate Velaj, Blerina Gjylameti etj. (në tërësi 14), kanë firmosur duke i kërkuar kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, shqyrtimin për miratim në Kuvend të nismës ligjore, projektligjin "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë". Ndërkohë që Federata Evropiane e Akademive të Shkencave Natyrore dhe Shoqërore bën thirrje për të mbrojtur lirinë akademike, projektligji që shndërron Akademinë në një organ këshillimor shkon në parlament. Në krye shënohet se Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit. Mes qëllimeve të saj renditet edhe një prej pikave të shumëreklamuara: të këshillojë e të ndihmojë me rekomandime, ekspertiza e oponenca qeverinë dhe institucionet qendrore për aspekte të rëndësishme të kërkimit shkencor, të formimit të specialisteve të lartë dhe të planifikimit të projekteve të së ardhmes. Sa i takon financimit, Akademia është një institucion buxhetor. Veprimtaria e saj financohet nga buxheti i shtetit, shërbimet tekniko-shkencore që kryhen për persona juridike e fizikë jashtë sistemit të saj, aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Të ardhurat nga sponsorizimet nuk zvogëlojnë buxhetin e përgjithshëm dhe ato përdoren sipas rregullores së brendshme përkatëse të Akademisë. Projektbuxheti i radhës i dërgohet ministrisë përgjegjëse për shkencën dhe komisionit parlamentar përkatës. Në komisionet parlamentare, Akademia ftohet ta mbrojë vetë projektbuxhetin e saj.









## KRYETARI

Në zbatimin e detyrave dhe kompetencave të tij, kryetari nxjerr urdhra e udhëzime dhe ushtron detyrën pas dekretimit të zgjedhjes nga Presidenti i Republikës. Në rast se Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda 45 ditëve, dekretimi konsiderohet i kryer në heshtje. Në relacionin shoqërues, vihet në dukje se qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i bazave juridike për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të reformimit të saj, si një institucion i rëndësishëm me ndikim në thellimin e reformave për kërkimin shkencor në vend. "Objektivat e projektligjit kanë të bëjnë me ndërtimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave në përshtatje me nevojat e zhvillimit të vendit si edhe nevojën e rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore e praktike dhe integritetit të kërkimit shkencor", thuhet në relacion.

## RISITË

Projektligji nuk përfshin më kategorinë e akademikut të përhershëm, duke iu dhënë akademikëve mbi 75 vjeç statusin Emeritus, që sipas relacionit i çliron ata nga disa detyrime institucionale të pjesëmarrjes në veprimtarinë e Akademisë, çka mundëson krijimin e vendeve të lira për rifreskimin e Akademisë me anëtarë të rinj. Projektligji krijon një hapësirë të re për përfshirjen si anëtarë të jashtëm të gjithkujt, me origjinë shqiptare, që ka një aktivitet të dallueshëm jashtë vendit e sidomos ndaj gjithkujt që ka fituar titullin "akademik" nga një akademi simotër. Ai parashikon funksionimin e Akademisë së të Rinjve, si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë së Shkencave, me synimin për të inkurajuar drejtpërsëdrejti veprimtarinë kërkimore shkencore të kërkuesve të rinj dhe për vendosjen e një ure komunikimi e promovimi me ta. "Përbërja e detyrat e Asamblesë" dhe përcakton se Asambleja përbëhet nga akademikët dhe akademikët e asociuar dhe numri i akademikëve është deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar është deri në 10; përcakton kërkesat e standardet e larta shkencore e profesionale për zgjedhjen e anëtarëve të Asamblesë, duke përcaktuar se në 3 procedurat e kandidimit e të përzgjedhjes përfshihen edhe struktura a përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor e të kulturës.

Projektligji nuk sjell si pasojë rritje të shpenzimeve buxhetore për Akademinë e Shkencave, as për institucione të tjera. Prej dy vitesh Akademia e Shkencave është në proces reformimi. Ndërsa, edhe pse kanë kaluar pesë muaj nga dorëzimi i projektligjit për këtë reformim në Kuvend, nuk ka pasur asnjë reagim konkret për miratimin apo mosmiratimin e tij nga qeveria. Tani mbetet për të parë, nëse iniciativa e deputetëve do ta bëjë qeverinë të ndryshojë mendim për projektligjin, që ka si qëllim reformimin e Akademisë së

Opinioni i Ditës

# Të ndihmojmë mësuesit të përsosin kompetencën e komunikimit

Nga Pëllumb Karameta

*(vijon nga faqja 1)*



... mund të mohohet se mësimi i gjuhës amtare është detyrë e arsimit parauniversitar dhe këtu ka shumë për të thënë, duke nisur që nga formimi i mangët i mësuesve të gjuhës shqipe e duke vijuar me programet mësimore të kësaj lënde, në të cilat gjuha shqipe përzihet me letërsinë, duke ndikuar për keq në përvetësimin e të dy lëndëve; me tekstet e gjuhës dhe të të gjitha lëndëve e niveleve të shkollimit, të korrektuara e të redaktuara keq, që nuk u japin nxënësve e studentëve gjedhe të gjuhës së përpunuar; dhe duke përfunduar me mungesën e kujdesit të trupës mësimore për të komunikuar me nxënësit në gjuhën standarde". Në vijim të këtyre konstatimeve, shtjellohen dy ide: a) zgjerimi i kuptimit për formimin gjuhësor në shkollë dhe b) investimi që mësuesit të përsosin kompetencën e komunikimit të nxënësve.

1. Kompetenca e komunikimit. Risia e reformës tonë kurrikulare është zhvendosja e theksit nga mësimdhënia për memorizimin e dijeve lëndore (edhe gjuhësore), te nxënia për formimin e kompetencave kyçe dhe aftësive bazë për zhvillimin personal, punësimin, përfshirjen sociale dhe qytetarinë aktive. Reforma është në linjë me rekomandimet e BE. Në maj 2018, Këshilli për Arsimin, Rininë, Kulturën dhe Sportin miratoi Rekomandimin e Këshillit, që zëvendësoi një Rekomandim të mëparshëm për promovimin e kompetencave kyçe dhe zhvillimin e shkathtësive bazë, duke theksuar: a) sigurimin e arsimit cilësor, trajnimit dhe të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë; b) ndihmën për personelin mësimor; c) promovimin e metodave dhe konteksteve të nxënies gjatë gjithë jetës; d) eksplorimin e qasjeve për vlerësimin dhe vlerën e kompetencave kyçe. Me synimin që, deri në vitin 2020, më pak se 15% e 15-vjeçarëve të klasifikohen në 'arritje të ulëta' në kompetencat kyçe, të matura nga testet PISA" [https://ec. europa. eu/education/policies/school/key-competences-and-basic-skills_en]. Testet PISA, lidhur me kompetencën e komunikimit, matin kapacitetin e nxënësve për të kuptuar, përdorur dhe reflektuar mbi tekstet e shkruara për të arritur qëllimet, për të zhvilluar njohuritë e potencialin dhe për të marrë pjesë në shoqëri.

Gjithë sa më sipër, formalisht, lidhet me punën e mësuesve të gjuhëve (shqipe dhe të huaja) të cilët mendohet se janë kontribuuesit kryesorë për ndërtimin e kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit saktë. Me ndërtimin e saj, nga nxënësit që mbarojnë arsimin 9 vjeçar pritet "të komunikojnë dhe shprehen me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe kodeve; flasin, dëgjojnë, lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën amtare dhe në (së paku) një gjuhë tjetër të huaj; përfshihen dhe kontribuojnë në dialog të respektueshëm dhe produktiv; japin dhe marrin informacion në mënyrë konstruktive dhe krijuese; respektojnë rregullat e përgjithshme të komunikimit / ndërveprimit dhe njëkohësisht dhe janë krijues; përdorin TIK-un dhe mediet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme si mjete të rëndësishme të informimit, të komunikimit dhe të ndërveprimit në epokën digjitale". (Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë). Them formalisht, pasi përgjegjësia për të aftësuar nxënësit të komunikojnë saktë ndahet mes mësuesve të gjuhëve dhe pjesës tjetër të personelit pedagogjik. Nga ky këndshikim, mjetet bashkëkohore me të cilët ndihmohen nxënësit të komunikojnë si duhet janë procesi i nxënies, mjetet mësimore, teknologjia digjitale dhe veprimtaritë mësimore/ edukative. Mjete të cilët mund e duhen përdorur nga personeli pedagogjik edhe në funksion të komunikimit efikas.

Gjithë sa më sipër u takon kuptimeve shkencore dhe standardeve zyrtare që mëtohet të arrihen nga nxënësit, të ndihmuar në rrugëtimin e tyre nga mësuesit, drejtuesit, autorët e teksteve, prindërit, mediat, ligjërimet publike, dekori i qytetit etj., etj. Ndërkaq, realiteti ofron të dhëna që meritojnë vëmendje. Për të ilustruar idenë, po sjellim disa shembuj. Në vlerësimin e paradokshëm të formimit gjuhësor të nxënësve të kl. III dhe V, AKP-ja konstatonte se "mungesa e zhvillimit të kompetencës së të lexuarit, që vihet re në testin e gjuhës shqipe, është e dukshme edhe në testin e matematikës, pasi nxënësit nuk lexojnë mirë kërkesat e pyetjes. Kjo shfaqet në zgjidhjen e problemës, në hartimin e pyetjeve dhe në nxjerrjen e përfundimit të saj; se 31. 17% e nxënësve kanë paqartësinë në atë që duan të shprehin, janë të paorganizuar dhe teksti i shkruar përmban shumë gabime drejtshkrimore apo përdorin gabim shenjat e pikësimit". Më tej: Një studiues tjetër konstatonte se "një pjesë e mirë e nxënësve të klasës X në një gjimnaz, në një projekt në lëndën e historisë, ndonëse paraqitën mendime me vlerë, bënin gabime të mëdha nga ana drejtshkrimore. Më e keqja: këto gabime nuk i kishte korrigjuar as mësuesi". Po kështu, një studim me studentë të Universitetit të Elbasanit ka treguar se "një student, në një tekst që shkruan, gabon mesatarisht 1 në 16 fjalë nga pikëpamja drejtshkrimore".

2. Të ndihmojmë mësuesit. Kushti i parë i nevojshëm që nxënësit të ndërtojnë dhe demonstrojnë kompetencën e komunikimit është zotërimi i standardeve gjuhësore nga mësuesit. Ky kusht duket që nuk përmbushet si duhet, pasi rreth 80% e mësuesve, sot në detyrë, janë diplomuar pas viteve '90. Cilësia jo e mirë e formimit (edhe gjuhësor) të nxënësve të pranuar në fakultetet e mësuesisë ka qenë shpesh temë e debateve dhe kritikave. Ndërkohë, përjashtuar fakultetet e gjuhësisë, përvetësimi i gjuhës shqipe standarde nuk ka qenë (dhe vijon të mos jetë) pjesë e planeve mësimore në fakultetet e tjera. Ndaj dhe cilësia e formimit gjuhësor të shumë mësuesve të diplomuar nuk kënaq.

Kushti i dytë është kompetenca profesionale e mësuesve për të organizuar një proces të nxëni cilësor. Cilësia e saj është cenuar nga filozofia arsimore që ka orientuar strategjitë dhe teknikat mësimore për formimin e mësuesit të ardhshëm. Për të vijuar të ndikojë, më pas, veprimtaritë për trajnimin e mësuesve në detyrë. Kjo filozofi dhe orientimet didaktike gjegjëse janë produkt i shkollave të mendimit pedagogjik që si qëllim të mësimdhënies nuk kishin formimin e kompetencave të nxënësve, por përvetësimin e përmbajtjeve lëndore (kategorive, ligjeve, rregullave disiplinore etj.). Kemi arsye të besojmë se ky kufizim ka cenuar vetë formimin fillestar dhe zhvillimin profesional të mësuesve. Ai, i jetësuar ditë pas dite në praktikat mësimore jo efikase në shkollë, frenon përvetësimin e teorive dhe të praktikave bashkëkohore të nxënies, të cilat janë themeli i ndërtimit / demonstrimit nga nxënësit edhe të kompetencës së komunikimit.

Nga ta nisim investimin? Historia e arsimit tonë ofron një përvojë interesante. Meqë zotërimi i standardit gjuhësor nga mësuesit është zemra e kompetencës së komunikimit të nxënësit, në vitet '80, Ministria e Arsimit mbështeti një projekt për riaftësimin gjuhësor të mësuesve. Instituti i Studimeve Pedagogjike përgatit një program orientues me elementët e rëndësishëm gjuhësorë që duhej të demonstronin mësuesit. Zbatimi i programit iu besua mësuesve të gjuhës, në çdo shkollë. Ata u orientuan paraprakisht nga specialistë të kualifikuar të gjuhës shqipe, në nivelin lokal. Më pas, mësuesi i gjuhës, përgjatë një semestri, në një ditë të javës, zhvillonte një seancë trajnimi 1,5 orë me mësuesit e shkollës. Në përfundim, përmes një testi, mësuesit e gjuhës vlerësuan dhe certifikuan pjesëmarrësit. Kjo strukturë projekti mund të shtojë vlerë, po të plotësohej me elementë të rinj. Të tillë mund të ishin, p.sh., pasurimi i programeve të licencimit të aspirantëve për mësues dhe i programeve të kualifikimit të mësuesve në detyrë, shërbimet që mund të ofrohen përmes teknologjive digjitale etj.

Nëse cilësia e një sistemi arsimor nuk e kalon cilësinë e mësuesve të tij dhe nëse e vetmja mënyrë për të përmirësuar rezultatet e nxënësve është përmirësimi i procesit të nxënies, ajo që vlen është rritja e interesit vetjak të mësuesve për të fituar njohuri të reja. Por do duhet edhe dikush, që t'i ndihmojë teknikisht të aftësohen të komunikojnë saktë. Që, më pas, ata të ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë dhe ushtrojnë kompetencën e komunikimit. Mundësia për këtë është shkëmbimi i njohurive/përvojave me njerëz të tjerë, sepse njohja që mësuesit arrijnë vetë mund të mos u mjaftojë të gjejnë shtegun e duhur. Ndërkaq, më e rëndësishme se njohuria është përvoja. Askush nuk mund t'i realizojë të gjitha përvojat e mira të kësaj bote, ndaj konsiderohet me vlerë edhe aftësimi i mësuesve për të arrirë përvojat e të tjerëve. E që kjo të ndodhë, ata duhen ndihmuar të nxënë si ta bëjnë këtë.

Opinioni i Ditës

# Të ndajmë "shapin nga sheqeri" diplomatik

Nga Jorgji Kote



*(vijon nga faqja 1)*

... të mbi 20 diplomatëve të shkarkuar/transferuar tri javë më parë. Qetësia dhe mirëkuptimi i tyre ishte vërtetë mbresëlënës dhe i natyrshëm, sepse pas mbi katër vite pune të vlerësuar në Bruksel, ata e dinin se një ditë do t'u vinte transferimi. Fjala është për Adrian Mara, diplomat për mbi tri dekada, me katër mandate jashtë vendit, veç MPJ-së, me gradë personale minister këshilltar; dhe zonjat Brunilda Koço e Blerta Derhemi, të cilat kanë rreth 15 vjet diplomate në Ministrinë e Jashtme dhe në mandatin e parë në Bruksel. Janë bashkëshorte dhe nëna korrekte, modeste, fjalëpakë e përherë në punë, siç ndodh në Bruksel. Nga të tre dëgjova vetëm fjalë të mira për kolegët dhe për drejtuesit e ministrisë, madje falë mirëkuptimit të tyre, ato do të punojnë në Bruksel deri më 30 qershor, duke mundësuar kësisoj kthimin normal në Tiranë me familjen dhe fëmijët.

Por, halli/mundimi i tyre më i madh nuk ishte transferimi me telashet e veta, por si të bindnin familjarët, miqtë dhe dashamirësit se nuk bëhet fjalë kurrsesi për largim apo shkarkim, ca më pak për ndonjë krushqi, mik e taraf! Keqkuptim që ka ndodhur pas njoftimit përkatës, i cili ndoshta pa dashje i "fuste të gjithë diplomatët në një thes" pa e ndarë "shapin nga sheqeri", ku dhe media ka ndikimin e vet.

Shqetësimi i dytë i madh është se në këtë listë përfshihet dhe Misioni ynë pranë BE-së, Bruksel, me tre diplomatët e lartpërmendur; pikërisht kur Komisioni Evropian sapo ka filluar hartimin e Progres Raportit lidhur me rekomandimin mbi çeljen ose jo të negociatave dhe në pritje të vendimit të vendeve anëtare. Gjatë 25 viteve të fundit, ajo është Përfaqësia jonë diplomatike me ngarkesën më të madhe dhe rezultatet më të mira, e lirë dhe e pastër nga çdo lloj afere apo aludimi sado të vogël. Mjaft të përmendet fakti se Komisioni dhe Parlamenti Evropian bashkë me Belgjikën dhe Luksemburgun që ajo mbulon me filialet e tyre kanë dhënë opinione pozitive për çeljen e menjëhershme të negociatave.

Pas 10 vite pune në dy mandate në atë Mision/Ambasadë deri në vitin 2017, tani që nuk jam më pjesë e shërbimit të jashtëm dhe i lirë nga çdo "konflikt interesi" dua ta përmend sërish se aty kanë shërbyer diplomatë dhe titullarë elitarë. Kështu, nga katër ish-shefa të tij, Artur Kuko, Ferit Hoxha dhe Ilir Tepelena vazhdojnë të drejtojnë ambasadat tona në Gjermani, UNESCO dhe Rumani, kurse zonja Mimoza Halimi është drejtore e Përgjithshme në MPJ; dy ish- punonjës të tjerë të këtij Misioni janë kryediplomatët tanë në Rusi dhe Greqi, kurse zoti Sokol Dedja në janar u emërua zv.ministër i Jashtëm, etj.

Aktualisht kjo Përfaqësi është më profesionistja dhe për herë të parë vitet e fundit me të dhjetë punonjësit e saj diplomatë karriere. Shquhet edhe për kombinimin optimal të moshës, profesionit dhe përvojës diplomatike brenda dhe jashtë vendit, ku mbizotëron me 80 për qind gjinia femër.

Shefja e Përfaqësisë, Suela Janina e ka pasuruar më tej këtë trashëgimi të pasur me energjinë, efektivitetin, punën në ekip, stilin tejet operativ dhe afërsinë me bashkatdhetarët tanë në Belgjikë dhe Luksemburg. Ndihesh vërtet mirë kur në Bruksel, Strasburg dhe Luksemburg dëgjon zyrtarë të lartë dhe të çdo formati të BE-së dhe nga vendet e lartpërmendura që shprehen aq vlerësues dhe jo thjesht për mirësjellje. Disa muaj më parë, në një takim të gjerë, një nga zv.Presidentët e Europarlamentit i ftoi të pranishmit të duartrokitnin gjatë për ambasadoren tonë në sallë, diçka e vërtet e rrallë. Mbi këtë bazë verën e kaluar, kryeministri Rama e vlerësoi zonjën Janina me medalje bashkë me tre ambasadorë të tjerë.

U ndala më gjatë te ky Mision, por ka edhe shumë përfaqësi e diplomatë të tjerë me karrierë të suksesshme dhe rezultate konkrete. Mund të jenë jo më pak se 150 diplomatë të tillë, që shërbejnë në përfaqësitë tona jashtë vendit dhe në Tiranë, shumë prej të cilëve me mbi 2-3 dekada punë në shërbimin e jashtëm mbajnë grada të larta diplomatike, kjo falë përkushtimit dhe ndihmesës së tyre në shumë procese jetike, sidomos për liberalizimin e vizave, anëtarësimin në NATO, marrjen e statusit kandidat në BE, proceset për Pavarësinë e Kosovës e deri te kryesimi vitin e ardhshëm i OSBE-së etj..

Këtu bëjnë pjesë edhe diplomatët e tjerë në Athinë, Nju Jork, Turqi, Austri etj., të liruar/transferuar/shkarkuar ditët e fundit; ndër ta ka ish-ambasadorë, ish-drejtorë dhe diplomatë me disa mandate, me grada të larta dhe me vlerësime të vazhdueshme shumë të mira pune. Sepse dy herë në vit edhe diplomatët vlerësohen me shkrim për punën në parametra të hollësishëm.

Është gjithashtu e vërtetë se gjatë 25 viteve të fundit, një numër i madh diplomatësh janë larguar nga reformat e vazhdueshme dhe për arsye të tjera. Rrjedhimisht, mbetet një numër fare i vogël diplomatësh që kanë qenë e mund të jenë problematikë, deri tek afera dhe skandale, madje shumica dërmuese janë personel teknik, sidomos shoferë. Por, pothuajse të gjithë të ardhur nga jashtë si shpërblim nga forcat politike në emër gjoja të kërkesave dhe nevojave të veçanta, ose me VKM të diskutueshme. Padyshim ka edhe nga ata që e kanë justifikuar veten, sikurse ka edhe plot të tjerë që nuk u gjendet "as nami dhe as nishani". Por, kanë lënë pas dëme të mëdha, sidomos për imazhin tonë, veç dëmtimit të karrierës së diplomatëve të aftë, të cilëve për pasojë nuk u ka ardhur asnjëherë "radha" për promovim. Lidhur me rolin e miqësive, krushqive dhe nepotizmit në diplomaci, ato janë të pashmangshme përderisa ekzistojnë edhe në shoqërinë tonë. Çështja është si të minimizohen e parandalohen dhe kryesorja, diplomatët e emëruar ta justifikojnë veten me procedura të drejta dhe rezultate të prekshme.

Në këtë drejtim duhet përshëndetur "guximi" për të lëvizur më në fund disa diplomatë të kooptuar nga jashtë sistemit, kryesisht falë lidhjeve familjare me VIP-a të medias dhe biznesit dhe jashtë kritereve përkatëse; ndër ta bien në sy dhe një apo dy, që falë "bujarisë" së pajustifikueshme të ish-drejtuesve të diplomacisë sonë kanë thyer rekordin botëror "Guines", duke shërbyer mbi 15 vjet në një vend të vetëm!

Po, në këtë tablo mbizotëruese të pamohueshme pozitive ka ndonjë rast negativ edhe nga diplomatë profesionistë me përvojë, që pësojnë "aksidente" teknike për gjëra që nuk kanë lidhje direkte me diplomacinë apo për aspekte me ndjeshmëri të lartë publike, shkelje të rregullave financiare e deri në grindje e sherre. Vetëm se si kudo në botë, këto raste trajtohen me kujdes dhe mbi baza ligjore, pa bujë mediatike, me analiza serioze dhe masa të ndryshme disiplinore, sipas ligjit dhe rregulloreve përkatëse.

Meqenëse po flitet shumë, për "ekselencë" pa nënvleftësuar rëndësinë e rezultateve të shkëlqyera universitare, le ta theksojmë se në diplomaci, vendimtare gjithsesi është përvoja, sepse siç thuhet, shpesh "praktika të bën perfekt". Ndaj, duke vlerësuar rinovimin e natyrshëm të diplomacisë sonë me elementë të rinj të shkëlqyer në mësime, që në fakt është bërë rregullisht këto vitet e fundit, kërkohet kujdes që të mos teprohet apo abuzohet me "ekselentët", sepse duhen vite që ata të fitojnë shprehitë dhe përvojën e duhur, derisa të bëhen diplomatë të vërtetë, duke e shoqëruar këtë proces me promovimin e merituar me grada diplomatike e jo sipas dëshirave, tekave dhe orekseve të njërit apo tjetrit. Pastaj, në asnjë vend të botës nuk lejohet që një rekrut i ri, sado "ekselent" të caktohet në një Përfaqësi jashtë vendit, pa kryer stazhin e nevojshëm në Ministrinë e Jashtme, në rastin tonë, sipas Ligjit dhe Rregullores mbi Shërbimin e Jashtëm të ndryshuar në vitin 2015! Diplomacia ndryshon shumë nga veprimtaria mësimore/akademike, ajo është zanat, profesion dhe pasion i veçantë, që kërkon kohë për "fermentim"; ndodh si me verën, sa më i vjetër e me përvojë diplomati, aq më i mirë dhe rezultativ do të jetë, dmth., gjithmonë dhe për çdo lloj moti (all weather diplomat).

Në vijim, këto cilësi të çojnë te kontinuiteti diplomatik, dmth., vazhdimin e përhershëm të karrierës, cilësi kryesore dalluese e diplomatit profesionist, e domosdoshme për të pasur përgjegjësi morale dhe ligjore dhe aksesin e nevojshëm në komunitetin diplomatik, si çelësi i suksesit afatgjatë. Mirëpo këto dhe të tjera cilësi nuk i ofron ekselenca shkollore, por eksperienca jetësore në shërbimin diplomatik.

Ja, pse jam dashamirësisht me ata që në respekt të hierarkisë tematike kanë sugjeruar që njoftimin e lartpërmendur publik, nëse do të ishte vërtet i nevojshëm, sërish mund ta kishte bërë një nga tre zëvendësministrat, sekretari i Përgjithshëm ose edhe zëdhënësi, sepse ministri qoftë edhe në detyrë, prononcohet për mesazhe madhore politike dhe strategjike dhe jo për shkarkime, transferime apo heqje targash/pasaportash diplomatike. Veç një gjuhe më të përshtatshme diplomatike të njoftimit në fjalë, theksi duhej vënë te përvoja dhe shembujt pozitivë, duke bërë dallim të qartë me rastet negative, sepse duke qenë "pakicë", përgjithësimi i tyre në publik dhe vendosja e shenjës së barazimit me shembujt pozitivë mund të kthehet në bumerang. Veç kësaj, ato ndikojnë negativisht edhe në imazhin e diplomacisë, sidomos në momentet madhore të politikës sonë të jashtme. Të huajt mund të mendojnë se kur ti ke "pellgje", "tarafe", nepotizëm etj., shkurt kur nuk ke në terezi Trupën Diplomatike me 300 apo 400 veta gjithsej, atëherë si do të jetë gjendja në fushat e tjera, tani kur ti kërkon çeljen e negociatave këtë qershor! Ndaj, edhe në diplomaci, përpara se të flitet për reforma dhe platforma, është e udhës të ndahet mirë "shapi nga sheqeri", ndryshe "bashkë me të thatin, do të digjet edhe i njomi".

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të refuzojnë të marrin përgjegjësinë për një grup njerëzish. Gara juaj për lidership do të ndalojë. Ekziston mundësia se nëse bini në kompromis, një konflikt afatgjatë ose një çështje e rëndësishme që ka lidhje me familjen tuaj mund të zgjidhet.

### DEMI

Demat do të kenë fat në marrëdhëniet profesionale. Ka gjasa të jeni pjesë e një takimi shumë të rëndësishëm, i cili mund të ndikojë në rritjen profesionale. Beqarët e kësaj shenje mund të nisin një marrëdhënie të re romantike, ndërsa çiftet e martuar rekomandohen të monitorojnë bisedat.

### BINJAKET

Punët të cilat kërkojnë shumë energji nga ana juaj, do t'i zgjidhni lehtësisht. Ndoshta ndihma do t'ju vijë nga persona, të cilët nuk i keni pasur miq në të kaluarën. Mbrëmjen kushtojani ndjenjave. Ftojeni partnerin/partneren në një darkë romantike.

### GAFORJA

Duhet të dëgjoni më shumë dhe të flisni më pak. Nuk është e nevojshme të shprehni çdo ide që keni ndërmend. Mbrëmjen kushtojani relaksit, shkoni në sauna ose në pishina. Mund të provoni edhe joga. Të gjitha këto do t'ju sjellin atë çfarë dëshironi.

### LUANI

Do të jetë një e premte pa ndonjë rezultat të rëndësishëm. Do të ndiheni të lodhur dhe nuk do të keni dëshirë të përfshiheni në aktivitete të ndryshme. Në mbrëmje do të jeni në një takim, ku do të jetë i pranishëm edhe një person me të cilin keni marrëdhënie konfliktuale.

### VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje sot nuk duhet t'u shmangen debateve. E vërteta lind nëpërmjet vështirësive dhe diskutimeve të nxehta. Kjo është veçanërisht e vërtetë për ata që diskutojnë rreth së ardhmes në familje. Gjysma e dytë e ditës premton të jetë mjaft harmonike.

### PESHORJA

Të lindurit e kësaj shenje do të ndihen paksa të mërzitur këtë të shtunë. Do të jeni të detyruar të qëndroni nën shoqëri të mërzitshme me persona shumë më të mëdhenj se ju. Megjithatë, pjesa tjetër e së premtes premton të jetë pozitive.

### AKREPI

Do të nisni një ndryshim dramatik në jetën tuaj. Nuk rekomandohet të jepni dorëheqjen në punë, pa gjetur një vend tjetër. Sa u përket financave, nuk do të jetë një ditë e mirë. Mendohuni mirë para se të aplikoni për një kredi të re.

### SHIGJETARI

Shigjetarët rrezikojnë të udhëhiqen nga dikush. Ndoshta rezultati i kësaj nuk do të jetë i pranueshëm nga ana juaj. Shmangni udhëtimet në kushte jo të përshtatshme. Gjithashtu, bixhozi dhe alkooli nuk janë të mirëpritur.

### BRICJAPI

Disa Bricjapë më 12 prill mund të tregojnë tension të tepruar në situata ku kërkohet butësi dhe takt. Ka gjasa që kjo t'ju sjellë rezultate negative. Largoni gjërat e panevojshme nga jeta juaj. Ecuria e kësaj dite do të varet vetëm nga ju.

### UJORI

Sot do të keni arsye për t'u ndjerë krenarë. Do të karakterizoheni nga një sharm mahnitës. Kjo do të bëjë që personat e seksit të kundërt të shfaqin interes ndaj jush. Nëse keni në plan të bëni disa ditë pushime, duhet të merrni në konsideratë dëshirat e familjarëve tuaj.

### PESHQIT

Peshqit do të luftojnë për një vend të mirë pune. Megjithatë, kur të hyni në këtë "luftë", gjeni aleatët e përshtatshëm. Shmangni këshillat e personave që nuk kanë kompetenca lidhur me këtë çështje. Në mbrëmje mund të merrni një lajm mjaft emocionues.

Eseja e Aleksandër Solzhenicin "Mos jeto me gënjeshtra" u botua së pari në "Washington Post" më 18 shkurt 1974. Ajo është mbase gjëja e fundit që ai shkroi në mëmëdhe përpara kolapsit të Bashkimit Sovjetik dhe qarkulloi ndërmjet intelektualëve të Moskës në atë kohë. Eseja është e datuar 12 shkurt, ditën që policia sekrete hyri më forcë në apartamentin e tij dhe e arrestoi. Ditën tjetër ai u dëbua në Gjermaninë Perëndimore. Teksti i saj është dhënë më poshtë. Megjithëse e shkruar me ish- Bashkimin Sovjetik në mendje, ajo është aktuale edhe sot në vendet e tjera.

# Mos jeto me gënjeshtra



Shkrimtari rus, Aleksandër Solzhenicin

Në një kohë, ne nuk guxonim as të pësh përisnim. Tani ne shkruajmë dhe lexojmë samizdat (kopje doreshkrimesh të ndaluara), dhe nganjëherë mblidhemi në dhomën e duhanit në Institutin e Shkencave ku i ankohemi çiltërsisht njëri-tjetrit: Çfarë lloj rrengjesh po na kurdisin dhe ku po na tërheqin zvarrë? Mburrje të panevojshme për arritje kozmike kur kemi kaq shumë varfëri dhe rrënim në shtëpi.

Të mbështesim regjime të largëta, të pacivilizuara. T'i bëjmë fresk luftës civile. Ne e ushqyem pa hesap Mao Ce Dunin në dëmin tonë- dhe do të jemi prapë ne që do të dërgohemi në luftë kundër tij, dhe do të na duhet të shkojmë. Dhe ata çojnë në ndjekje penale këdo që dëshirojnë dhe vënë njerëzit e ndershëm në spitale për të çmendur-gjithnjë ata dhe ne përsëri jemi të pafuqishëm. Gjërat kanë arritur pothuajse fundin e durimit. Një vdekje shpirtërore universale na ka prekur tashmë të gjithëve dhe vdekja fizike do të flakërojë shpejt dhe do të na tresë ne dhe fëmijët tanëpor si më përpara ne ende buzëqeshim në një mënyrë të frikshme dhe belbëzojmë me gjuhët e lidhura. Por çfarë mund të bëjmë për ta ndaluar këtë? A nuk kemi forcë?

Ne jemi çnjerëzuar kaq pa shpresë saqë për një racion modest të së sotmes, do të hiqnim dorë nga të gjitha parimet, nga shpirti ynë dhe të gjitha përpjekjet e paraardhësve tanë dhe të gjitha shanset për pasardhësit gjithashtu - vetëm që të mos trazonim ekzistencën tonë të brishtë. Ne na mungon besimi në vetvete, krenaria dhe entuziazmi. Madje nuk kemi frikë as vdekjen nukleare universale dhe as një luftë të tretë botërore gjithashtu. Ne tashmë kemi gjetur strehim në skuta. Kemi frikë vetëm aktet e kurajës civile.

Kemi frikë vetëm të mbetemi prapa kopesë dhe të bëjmë një hap vetëm dhe papritur pastaj të gjendemi pa bukë të bardhë, pa gaz për ngrohje dhe pa leje banimi në Moskë.

Jemi indoktrinuar në kurse politike dhe po në të njëjtën mënyrë ishte farkëtuar ideja për të jetuar pa andralla dhe gjithçka do të jetë mirë për pjesën e jetës që na ka mbetur. Ju nuk mund t'i ikni mjedisit tuaj dhe kushteve sociale. Jeta e përditshme do ndërgjegjësim. Çfarë ka kjo të bëjë me ne? A s'mund të bëjmë pa të?

Po, ne mundemi - çdo gjë. Por ne gënjejmë veten për këtë siguri. Dhe nuk janë ata që duhet të fajësohen për çdo gjë- ne vetë, vetëm ne. Dikush mund të kundërshtojë: Na kanë futur tapa në gojë. Askush s'do të na dëgjojë dhe askush nuk na pyet. Si mund t'i detyrojmë ata të dëgjojnë? Është e pamundur t'ua ndryshojmë mendjen.

Do të ishte e natyrshme për t'i nxjerrë nga zyra me votë - por nuk ka zgjedhje në vendin tonë. Në Perëndim, njerëzit përdorin grevat dhe demonstratat e protestëspor ne jemi shumë të shtypur dhe kjo është një perspektivë shumë e zymtë për ne: Si mundemi ne befas të heqim dorë nga puna dhe të dalim në rrugë? Megjithatë, rrugët e tjera fatale të kërkuara gjatë shekullit të kaluar nga historia jonë e hidhur ruse janë, prapëseprapë, jo për ne dhe vërtet nuk kemi nevojë për to.

Tani që satrat kanë bërë punën e tyre, kur çdo gjë që u mboll ka nxjerrë filiza të reja, mund të shohim që të rinjtë dhe njerëzit fodullë të cilët mendonin se do ta bënin vendin të drejtë dhe të lumtur përmes terrorit, rebelimit gjakësor dhe luftës civile, ishin mashtruar. Jo faleminderit, baballarë të edukimit! Tani e dimë se metodat famëkeqe prodhojnë me shumicë produkte famëkeqe. Na i lini duart tona të pastra!

Qarku - a është i mbyllur? Dhe a ka realisht ndonjë rrugëdalje? A ka vetëm një gjë që na ka mbetur për të bërë, të presim pa ndërmarrë ndonjë veprim? Mbase diçka do të ndodhë vetvetiu? Kurrë nuk do të ndodhë për sa kohë sa në përditshmërinë tone, ne nuk do të ndahemi prej aspekteve të saj më të perceptueshme: Gënjeshtrave.

Kur dhuna ndërhyn në jetën paqësore, fytyra e saj skuqet me vetë-besim sikur po mbart një parullë dhe një thirrje: "Unë jam dhuna. Largohuni, më hapni rrugë- Do t'ju shtyp." Por dhuna vjetërohet shpejt. Ajo e humb besimin tek vetvetja dhe me qëllim që të ruajë sedrën, ajo thërret falsitetin si aleatin e saj - meqë dhuna i shtrin putrat e saj të rënda jo për çdo ditë dhe jo mbi çdo sup. Ajo kërkon prej nesh vetëm bindje për gënjeshtrat dhe pjesëmarrje të përditshme në gënjeshtrat e saj- e gjithë besnikëria qëndron aty.

Dhe çelësi më i thjeshtë dhe më i përdorshëm për çlirimin tonë të vetë-neglizhuar gjendet pikërisht këtu: Mospjesëmarrje personale në gënjeshtra. Megjithëse gënjeshtrat fshihen pas çdo gjëje, megjithëse gënjeshtrat përqafojnë çdo gjë - por jo me ndihmën time.

Kjo hap një të çarë në qarkun imagjinar të shkaktuar nga mosveprimi ynë. Kjo është gjëja më e thjeshtë që mund të bëjmë por më shkatërruesja për gënjeshtrat ose mashtrimet. Sepse kur njerëzit i refuzojnë gënjeshtrat, kjo thjesht ua shkurton ekzistencën. Si një infeksion, ai mund të ekzistojë vetëm në një organizëm të gjallë.

Nuk e shtrëngojmë veten. Akoma s'na është krijuar bindja e mjaftueshme për të marshuar në sheshe dhe për t'u çjerrë për të vërtetën apo ta shprehim me zë të lartë atë që mendojmë. Nuk është e domosdoshme. Është e rrezikshme. Por le të refuzojmë të themi atë që nuk e mendojmë.

Kjo është rruga jonë, më e thjeshta dhe më e mundshmja që merr në konsideratë frikën tonë të brendshme, tashmë të rrënjosur thellë. Dhe është shumë më e lehtë-është e rrezikshme madje ta themi edhe këtë -sesa lloji i mosbindjes civile që Gandi mbronte.

Rruga jonë është t'i ikim vijës të gangrenizuar. Nëse ne nuk i ngjisim bashkë kockat e vdekura dhe shkallët e ideologjisë, nëse ne nuk qepim bashkë rreckat e kalbura, ne do të çuditemi sa shpejt gënjeshtrat do të mbeten pa mbështetje dhe do të fundosen.

Ajo e cila duhet te jetë e zhveshur, do të shfaqej pastaj me të vërtetë e zhveshur përpara gjithë botës.

Kështu në ndrojtjen tonë, le të bëjmë secili një zgjedhje: nëse do të mbetemi një shërbyes i ndërgjegjshëm i falsitetit (natyrisht, kjo nuk vjen nga prirja, por për të ushqyer familjen, që të rrisim fëmijët me frymën e gënjeshtrave). Apo të shkundemi nga gënjeshtrat dhe të bëhemi një njeri i ndershëm që meriton respekt nga fëmijët e tij dhe bashkëkohësit.

Dhe që nga ajo ditë e në vazhdim ai/ajo:

♦ Nuk do të shkruajë, firmosë apo shtypë në ndonjë mënyrë asnjë frazë të vetme që për mendimin e tij shtrembëron të vërtetën.

♦ Nuk do të nxjerrë ndonjë frazë të tillë as në biseda private as në praninë e shumë njerëzve, as në emrin e tij dhe as nën shtytjen e dikujt tjetër, as në rolin e propaganduesit, mësuesit apo edukatorit apo në një rol teatral.

♦ Nuk do të përshkruajë, ushqejë apo shpërndajë asnjë ide të vetme të cilën ai e konsideron si të rreme apo shtrembërim të së vërtetës pavarësisht se mund të jetë në pikturë, skulpturë, fotografi, shkenca teknike apo muzikë.

♦ Nuk do të citojë jashtë nga konteksti verbalisht ose në mënyrë të shkruar asnjë citat të vetëm në mënyrë që të kënaqë dikë, të pasurojë dikë apo që dikush të arrijë sukses në punë nëse edhe ai vetë nuk ndan plotësisht të njëjtën mendim apo nëse kjo nuk pasqyron saktësisht çështjen për të cilën bëhet fjalë.

♦ Nuk do t'ia lejojë vetes të detyrohet të ndjekë manifestime apo takime nëse ato janë në kundërshtim me dëshirën apo vullnetin e tij, nuk do të mbajë në duar apo të ngrejë lart një poster apo slogan për të cilin nuk bie dakord plotësisht.

♦ Nuk do të ngrejë dorën për të votuar për një propozim të cilin nuk e simpatizon sinqerisht,

♦ Nuk do të votojë as hapur as fshehur për një person të cilin e konsideron të pavlefshëm apo me aftësi të dyshimta.

♦ Nuk do t'ia lejojë vetes të tërhiqet zvarrë për të marrë pjesë në një takim ku mund të pritet një diskutim i sforcuar apo i shtrembëruar për një çështje.

♦ Do të dalë menjëherë jashtë nga një takim, leksion, shfaqje apo film nëse dëgjon një folës që tregon gënjeshtra, thotë dokrra ideologjike apo bën propagandë të paturpshme.

♦ Nuk do të abonohet apo blejë një gazetë apo revistë në të cilën informacioni është i shtrembëruar dhe faktet kryesore janë fshehur.

Sigurisht se nuk kemi listuar të gjithë deviacionet e mundshme dhe të domosdoshme nga falsiteti. Por një person që e pastron veten do të dallojë lehtë shembuj të tjerë me këndvështrimin e tij personal.

Jo, kjo nuk do të jetë e njëjtë për të gjithë në fillim. Disa në fillim edhe mund të humbasin punën. Për të rinjtë që dëshirojnë të jetojnë me të vërtetën, kjo mënyrë sjellje do të komplikojë jetën e tyre sepse recitimet e kërkuara janë të mbushura me gënjeshtra dhe është e domosdoshme për të bërë një zgjedhje.

Por nuk ka rrugë të tjera për dikë që dëshiron të jetë i ndershëm. Në një ditë të caktuar, secili prej nesh do të përballet me të paktën një nga zgjedhjet e lartpërmendura madje edhe në më të sigurtën e shkencave teknike. Ose të vërtetën ose falsitetin: drejt pavarësisë shpirtërore apo drejt robërisë shpirtërore.

Dhe ai që nuk është mjaftueshëm kurajoz që të mbrojë shpirtin e tij- mos e lër të jetë krenar për pikëpamjet e tij "progresive' dhe mos e lër të mburret që ai është një akademik apo artist, figurë e merituar apo gjeneral- t'i thotë vetes: Unë jam pjesë e kopesë dhe jam një frikacak. Është e njëjta gjë edhe për mua me qëllim që të ushqehem dhe mbahem ngrohtë.

Madje edhe kjo rrugë, e cila është më modestja e të gjithë rrugëve të rezistencës, nuk do të jetë e lehtë për ne. Por ajo është shumë më e lehtë sesa vetë-flijimi apo greva e urisë. Flakët nuk do të përfshijnë trupin tuaj, vetullat nuk do t'ju digjen nga i nxehti dhe bukën e zezë dhe ujin e pastër do t'i keni gjithnjë në familjen tuaj.

Një popull i madh i Evropës, çekosllovakët, të cilët ne i kemi tradhtuar dhe mashtruar: A nuk na kanë treguar ata sesi një gjoks i rrezikuar mund të qëndrojë edhe përballë tankeve nëse ka një zemër të denjë brenda saj?

Ju thoni se kjo nuk do të jetë e lehtë? Por do të jetë më e lehta nga të gjitha mjetet e mundshme. Nuk do të jetë një zgjedhje e lehtë për një trup por është e vetmja për një shpirt. Nuk është një rrugë e lehtë. Por ka tashmë shumë njerëz, madje me dhjetëra, të cilët në vite kanë mbajtur këto parime dhe kanë jetuar për të vërtetën.

Prandaj nuk do të jeni i pari që do ta merrni këtë rrugë, por do t'iu bashkoheni atyre që e kanë ndërmarrë tashmë. Kjo rrugë do të jetë më e lehta dhe më e shkurtra për të gjithë ne nëse e marrim me përpjekje të përbashkëta dhe në radhë të ngushta. Nëse jemi me mijëra, ata nuk do të jenë në gjendje të na bëjnë asgjë. Nëse jemi me dhjetëra mijëra, atëherë nuk do ta njihnim vendin tonë si do të shndërrohej.

Nëse jemi shumë të frikësuar, atëherë duhet të ndalojmë së ankuari se dikush po na merr frymën. Atëherë do të përulemi edhe më shumë, do të qahemi dhe vëllezërit tanë, biologët do ta kenë më të afërt ditën që kur ata të jenë të aftë të lexojnë mendimet tona, ato do të jenë pa vlerë dhe pa shpresë.

Dhe nëse na ftohen këmbët, edhe duke ndërmarrë këtë hap, atëherë jemi me të vërtetë të pavlefshëm dhe të pashpresë dhe do ta meritonim shpotinë e Pushkinit:

Pse duhet ta kenë bagëtitë dhuratën e lirisë?
Trashëgimia e tyre brez pa brezi është zgjedha dhe dajaku.

*Përktheu: Kujtim Morina*


GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
RUSSIA 2018
LAJME
KALENDARI
www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
MARKETING: 0688087323
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
Life
Brikena Duva:
VIP
BLUE TOOTH
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al